Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Raporti i Punës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014

Prishtinë, 2015

www.kqz-ks.org

RAPORTI I PUNËS I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2014

Publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2015.

Për më shumë informacion kontaktoni Sekretariatin e KQZ-së,
Adresa: Rr. Migjeni p.n Prishtine 10000.
Telefoni: +381 (0) 38 200 211 337, E-mail info@kqz-ks.org

© Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 2015

Version elektronik i këtij dokumenti është në dispozicion në linkun: http://www.kqz-ks.org/sq/publikime

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit
Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke u bazuar në obligimin e përcaktuar në nenin 63.10 të Ligjit nr. 03/L073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, t`i paraqes Kuvendit të Republikës së Kosovës, Raportin e punës për vitin 2014.

Raporti i punës i KQZ-së për vitin 2014, është analitik, pasqyrues dhe është strukturuar në rubrika sipas kronologjisë së etapave për tërë vitin 2014, por edhe në aktivitetin dhe veprimtarinë funksionale të KQZ-së. Viti 2014 ka qenë vit zgjedhor, ku në bazë të kalendarit zgjedhor janë planifikuar të mbahen zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Krahas kësaj, në muajin shkurt janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut.
Në funksion të organizimit dhe administrimit të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2014, KQZ-ja ka ndërmarrë të gjitha aktivitetet operacionale dhe mbështetëse, me qëllim të përmbushjes së rolit dhe misionit kushtetues dhe ligjor të proceseve zgjedhore.

Duke pasur parasysh se zgjedhjet u mbajtën në një afat kohor përgatitor shumë të ngjeshur, me angazhim serioz dhe përkushtim në cilësinë e përmbushjes së aktiviteteve dhe duke respektuar afatet ligjore, zgjedhjet u vlerësuan të lira, mirë të organizuara, transparente dhe demokratike nga vëzhgues vendorë dhe ndërkombëtarë.

Raporti krahas realizimeve dhe arritjeve, pasqyron edhe problematikat, duke u fokusuar në çështjet që lidhen me ecurinë e punës së KQZ-së, debatin dhe vendimmarrjen e saj, të cilat janë element kryesorë të funksionimit të një institucioni.

Duke mirëpritur vlerësimin dhe rekomandimet e juaja për këtë raport në vijim, KQZ-ja në mënyrë të pakushtëzuar mbetet e angazhuar për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor, të drejtën kushtetuese të votës, lirinë dhe barazinë e saj.

Valdete Daka,

Kryetare e KQZ-së

LISTA E SHKURTESAVE

ACEEEO	Asociacioni i Zyrtarëve Zgjedhorë Evropianë
BE	Bashkimi Evropian
DPA	Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve
FPR	Formulari i Përputhjes së Rezultateve
FRK	Formulari i Rezultateve të Kandidatëve
IFES	Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore
KGJK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KKZ	Komisionet Komunale të Zgjedhjeve
KVV	Këshillat e Vendvotimeve
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LV	Lista Votuese
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administratës dhe e Pushtetit Lokal
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integrimeve Evropiane
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizatat Joqeveritare
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PZAP	Paneli Zgjedhor për Parashtresa dhe Ankesa
QNR	Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve
QV	Qendra e Votimit
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
SHV	Shërbimi Votues
VV	Vendvotimet
ZFK	Zarfi i Fletëvotimit me Kusht
ZRPP	Zyra për Regjistrim të Partive Politike

PËRMBAJTJA

1 Përmbledhje ekzekutive 5
2 Korniza Ligjore 6
3 Përshkrimi i institucionit 7
3.1 Misioni 7
3.2 Vizioni 7
3.3 Kompetencat e KQZ-së sipas ligjit 7
4 Fushëveprimi që e mbulon institucioni 8
4.1 Mandati i KQZ-së 8
4.2 Përgjegjësitë dhe kompetencat 8
4.3 Funksionalizimi i KQZ-së 8
4.4 Këshillat e KQZ-së 9
4.5 Sekretariati i KQZ-së 10
4.6 Burimet Njerëzore 10
4.7 Asetet 12
5 Aktivitetet për periudhën raportuese 14
5.1 Aktivitetet e përgjithshme gjatë periudhës jo zgjedhore 14
5.2 Buxheti dhe Financat 18
5.3 Prokurimi 28
5.4 Auditimi i Brendshëm 31
6 Aktivitetet gjatë periudhës Zgjedhore 33
6.1 Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2014 33
6.1.1 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve 34
6.1.2 Akreditimi i vëzhguesve 35
6.1.3 Raportimi Financiar i Fushatës Zgjedhore 35
6.1.4 Lista Përfundimtare e Votuesve 36
6.1.5 Votimi jashtë Kosovës 40
6.1.6 Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta 43
6.1.7 Informimi Publik 44
6.1.8 Trajnimi i KKZ-ve dhe KVV-ve 44
6.2 Numërimi dhe tabulimi i rezultateve 54
6.3 Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut 57

7 Sfidat dhe rekomandimet 60
7.1 Sfidat dhe mangësitë 60
7.2 Rekomandimet.....61
8 Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.....63
9 Shtojcat 70

1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në pajtim me obligimet që dalin me nenin 63.10 të Ligjit Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale në Republikën e Kosovës, paraqet raport pune për Kuvendin e Kosovës, me qëllim të informimit me aktivitetin e KQZ-së për vitin 2014, të pasqyruar në këtë raport, duke dëshmuar rolin dhe përgjegjësitë që ka me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale.

Raporti paraqet informacione përmbajtjesore lidhur me progresin e angazhimeve të KQZ-së në arritjen e prioriteteve, objektivave dhe qëllimeve strategjike, si të tilla të përcaktuara me ligjet burimore dhe planin vjetor te punës.

Ne këtë raport janë pasqyruar aktivitetet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në vitin 2014, në funksion të organizmit të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtura me 8 Qershor 2014 dhe zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune ne Mitrovicën e Veriut, të mbajtura me 23 shkurt 2014, si dhe aktivitetet tjera mbështetëse dhe të planifikuara me Planin Vjetor të Punës.

Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të planifikuara të mbahen në fund të vitit, janë mbajtur me 8 qershor. Gjithashtu, me vendim te Presidentes, më 23 shkurt të vitit 2014 janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicen e Veriut. Këto rrethana të reja të krijuara kanë detyruar KQZ-në të bëjë formatimin e aktiviteteve të planifikuara, duke ngjeshur kohëzgjatjen e aktiviteteve mbështetëse dhe rritur vëllimin e angazhimit në raport me afatet e reja kohore. Afati i shkurtër për organizimin e zgjedhjeve ishte sfide e madhe. Mirëpo, përkundër këtij fakti, organizimi i Zgjedhjeve të parakohshme është vlerësuar se ka përmbushur standardet dhe praktika me të mira ndërkombëtare dhe ka krijuar një standard te ri në organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor ne Kosovë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në kuadër të përgjegjësive ligjore, gjatë vitit 2014 ka arritur t'i realizojë shumicën e qëllimeve dhe objektivave të parapara me Planin e Punës. Megjithatë, ende mbeten sfida, që kanë të bëjnë me organizimin dhe administrimin e proceseve zgjedhore.

2 KORNIZA LIGJORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm dhe i pavarur, i përcaktuar me nenin 139 te Kushtetutës se Republikës se Kosovës[1].

Me qëllim të organizimit të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendin e Kosovës dhe me qëllim të fuqizimit të qeverisjes demokratike në Kosovë, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS. Më 29 tetor 2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar LIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.

Po ashtu, me qëllim të administrimit të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendet e Komunave dhe Kryetarët e Komunave, si dhe me qëllim të fuqizimit të qeverisjes lokale demokratike, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar LIGJIN PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.

Ligji per Financimin e Partive Politike rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për shpenzimin e pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka nxjerrë 17 rregulla të cilat, sqarojnë dispozitat e ligjit dhe japin më shumë hollësi, se si të zbatohen ato në praktikë. Ato trajtojnë aspektet kryesore të procesit zgjedhor. Kohë pas kohe, KQZ-ja e ka plotësuar rregullativën ligjore duke i bërë gjithnjë e më të zbatueshme në praktikë këto akte nënligjore.

KQZ-ja ka miratuar edhe Rregulloren e Punës, si akt i brendshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që përcakton organizimin dhe mënyrën e funksionimit të tij, duke rregulluar çështjet si në vijim:

---

1 Kapitulli XII [Institucionet e Pavarura], Neni 139 , Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

3 PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1 Misioni

KQZ-ja është e përkushtuar të organizojë zgjedhje kredibile dhe me standarde të larta, duke u ofruar të gjithë qytetarëve mundësi dhe shërbime cilësore zgjedhore që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

3.2 Vizioni

Vizioni i KQZ-së është për një institucion të qëndrueshëm dhe inovativ, që forcon demokracinë përmes zgjedhjeve, të cilat gëzojnë besimin e qytetarëve dhe akterëve tjerë.

3.3 Kompetencat e KQZ-së sipas ligjit

Gjatë zbatimit të mandatit të vet KQZ-ja:

a) ndërmerr aktivitete për edukimin e votuesve të përgatitura për ngritjen e vetëdijesimit të votuesit për, dhe pjesëmarrjen në zgjedhje;

b) ndërmerr projekte ose kërkime lidhur me sistemin zgjedhor dhe çështjet lidhur me të;

c) krijon procedura të përshtatshme dhe ndërmerr aktivitete për të garantuar se të gjithë personat me aftësi të kufizuara mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit dhe të marrin pjesë tërësisht në procesin zgjedhor në Kosovë; dhe

d) kryen çdo funksion tjetër ndihmës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë që i përcaktohet me Rregulloret relevante dhe instrumentet ndihmëse, përfshirë veprimet e domosdoshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor në rast shfaqjeje të një force madhore.

4 FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI

4.1 Mandati i KQZ-së

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

4.2 Përgjegjësitë dhe kompetencat

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton në mënyrë të përgjithshme përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ-së, ndërsa me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, janë përcaktuar në mënyrë më të specifikuar këto përgjegjësi dhe funksione të KQZ-së, duke përfshirë edhe ato të Sekretariatit të KQZ-së dhe të Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike. Neni 64 i këtij Ligji, përcakton qartë përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ-së, si:

a) *Përgatitja dhe shpallja e rregullave, formave dhe procedurave zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji, dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencave të veta*

b) *Publikimi i të gjitha rregullave të miratuara, rregullave, udhëzimeve dhe procedurave zgjedhore duke i bërë ato të arritshme për opinionin.*

c) *Krijimi dhe mbajtja e Listës së Personave që kanë të dejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta.*

d) *Mbajtja e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikimin e Partive Politike në mënyrën e paraparë me këtë ligj.*

e) *Përpilimi dhe miratimi i Fletëvotimeve dhe i materialeve të tjera zgjedhore.*

f) *Akreditimi i Vëzhguesve të zgjedhjeve.*

g) *Certifikimi i Listës së Votuese lidhur me zgjedhjet.*

h) *Certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve.*

4.3 Funksionalizimi i KQZ-së

Përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është e përcaktuar me Kushtetutë. Neni 139, paragrafët 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e rregullojnë saktësisht përbërjen dhe emërimin e kryesuesit të KQZ-së dhe anëtarëve të KQZ-së si në vijim: Komisioni përbëhet

nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli. Gjashtë (6) anëtarë të tjerë, emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës, dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.
Valdete Daka - është emëruar me 16 qershor 2010 anëtare dhe kryetare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
Anëtarët e KQZ-së, sipas propozimit të Grupeve Parlamentare dhe të partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, të cilët janë emëruar nga Presidentja e Kosovës me 16 dhjetor 2014 janë:

1. Betim Gjoshi - i nominuar nga Grupi Parlamentar PDK,
2. Florian Dushi - i nominuar nga Grupi Parlamentar LDK,
3. Adnan Rrustemi - i nominuar nga Lëvizjes Vetëvendosje,
4. Binak Vishaj - i nominuar nga Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës,
5. Eshref Vishi - i nominuar nga Nisma për Kosovën,
6. Ilir Gashi – i nominuar nga Grupi Parlamentar PDK,
7. Nenad Rikalo - i nominuar nga Listës Serbe,
8. Ercan Spat - i nominuar nga Partia Demokratike Turke të Kosovës,
9. Bajram Ljatifi - i nominuar nga Koalicioni VAKAT,
10. Ergit Qeli - i nominuar nga Partia Liberale Egjiptiane.

Kryesuesi i KQZ-së nuk shërben në më shumë se dy (2) mandate të njëpasnjëshme ndërsa Anëtarët e KQZ-së nuk shërbejnë në më shumë se tri (3) mandate të njëpasnjëshme.

4.4 Këshillat e KQZ-së

Në bazë të Rregullores së Punës, KQZ-ja është organizuar në pesë këshilla të përhershëm:

- Këshilli për Operacione Zgjedhore
- Këshilli i Procedurave
- Këshilli i Personelit

- Këshilli i Buxhetit dhe Prokurimit
- Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Roli i tyre është shqyrtimi i çështjeve të caktuara dhe përgatitja e rekomandimeve apo e raporteve për miratim nga KQZ-ja.

4.5 Sekretariati i KQZ-së

Sekretariati i KQZ-së është një trupë administrative-teknike, e themeluar nga KQZ-ja për të ndihmuar KQZ në kryerjen e përgjegjësive dhe të funksioneve të saj. SKQZ, i zbaton vendimet e KQZ-së, përgatitë raporte dhe rekomandime për KQZ-në,

Zyra për Regjistrimin e partive Politike dhe Certifikim

KQZ-ja në pajtueshmëri me ligjin, ka themeluar Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (Zyra e ZRPPC-së). Zyra, është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe azhurnimin e Regjistrit të Partive Politike, për certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre për zgjedhje, kufizimin e shpenzimeve të subjekteve të certifikuara politike gjatë fushatave, si dhe pranimin e Deklarimeve të Financave të kandidatëve për zgjedhje. Zyra udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv, i cili i raporton drejtpërdrejtë KQZ-së.

Komisionet Komunale Zgjedhore

KKZ-të janë trupa të themeluara nga KQZ-ja në tridhjetë e tetë komunat (38) e Republikës së Kosovës për të ndihmuar në organizimin e zgjedhjeve. Ato janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve përbrenda komunave, nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e KQZ-së nëpërmjet Sekretariatit, me qëllim të garantimit të ligjshmërisë, legjitimitetit dhe efikasitetit të procesit zgjedhore.

4.6 Burimet Njerëzore

Në vitin 2014, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka aprovuar 88 zyrtarë, prej te cilëve 11 janë anëtarë të KQZ-së ndërsa 77 janë zyrtarë të Sekretariatit të KQZ-së.
Nga 77 zyrtarë të SKQZ-së, 38 janë zyrtarë të lartë komunal cka do të thotë se nga një zyrtarë është në secilën komunë të Kosoves.

a) Struktura kualifikuese e Stafit të SKQZ-së

Totali	Struktura kualifikuese			
	Fakulteti	Shkollë e lartë	shkollë e mesme	Shkollë fillore
72	60	2	10	

b) Struktura etnike e Stafit të SKQZ-së

Struktura etnike								
shqiptarë	serbë	boshnjakë	turq	goranë	ashkali	egjiptianë	rom	të tjerë
62	9		1					

c) Struktura gjinore e Stafit të SKQZ-së

Struktura gjinore	
meshkuj	femra
51	21

Struktura aktuale organizative është miratuar nga KQZ-ja , me datë 4 korrik 2013, me vendim Nr. 627-013. [2] Në kuadër të Sekretariatit përveç ZRPPC-së ekzistojnë 4 departamente :

- Departamenti i Operacioneve Zgjedhore,
- Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes,
- Departamenti për çështje Ligjore,
- Departamenti për Teknologji Informative,

Në kuadër të Zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv vepron Koordinimi në teren, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, Auditimi i Brendshëm dhe Prokurimi.

Trajnimi i Stafit

Gjatë vitit 2014, duke pas parasysh nevojën për ngritjen profesionale të stafit, janë vijuar trajnime profesionale brenda dhe jashtë vendit. Trajnimet i kanë vijuar pjesa dërmuese e stafit të SKQZ-së, temat e trajnimeve janë: Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm, Përafrimi me ligjet

[2] Struktura aktuale organizative është paraqitur si *Shtojca 4- Organogrami*

e BE-së dhe Teknikat e hartimit të ligjeve, Kursi hyrës për Bashkimin Evropian, Proceset dhe Procedurat për Auditim e Burimeve Njerëzore, Analizimi i të dhënave sasiore përmes SPSS, Microsoft Windows Server, Marrëdhënie me publikun. Gjithashtu, falë bashkëpunimit me asociacionin A-Web, tre zyrtarë të Sekretariatit kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga A-Web me temën Ndërtimi i kapaciteteve të trupave të menaxhimit zgjedhore në Republikën e Koresë.

NR.	Emërtimi i trajnimit	Organizatori	Nr i zyrtarëve
1	Trajnimi në Microsoft Windows Server 2012 R2	AUK Institute - Prishtinë	4
2	E drejta e qasjes në dokumente publike	IKAP	2
3	Komunikimi, Konfliktet, Ekipet dhe puna ekipore	IKAP	2
4	Menaxhimi i projekteve	IKAP	2
5	Rekrutimi dhe selektimi ne Shërbimin civil	IKAP	1
6	E drejta për mbrojtjen e informatorit dhe ndërlidhja me legjislacionin e administratën publike	IKAP	2
7	Qasja në fondet e BE-së dhe menaxhimi I tyre	IKAP	2
8	Trajnime në fushën për çështje të BE-së	IKAP	1
9	Proceset dhe Procedurat për Auditim e Burimeve Njerëzore	IKAP	1
10	Programi i Ndërtimit te Kapaciteteve të Trupave Menaxhuese Zgjedhore	AWEB-Seul	3
11	Trajnim në SPSS	Eunacal Institute - Tiranë	11

Tabela 1: Tabela e trajnimeve të stafit të KQZ-së

4.7 Asetet

	2014	2013	2012
Klasifikimi i pasurive	€ '000	€ '000	€ '000
Ndërtesat			
Toka			
Pajisjet			
Infrastruktura			
Makineria			
Automjetet	83	56	86

Tjera	42	72	13
Gjithsej	125	127	99

Tabela 2: Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000 euro) të KQZ-së

Sipas sistemit SIMFK vlera e pasurisë kapitale mbi 1000 euro është 125,195.79 euro.

	2014	2013	2012
Klasifikimi i pasurive	€ '000	€ '000	€ '000
Pajisjet dhe mobiljet	678	603	400
	678	603	400

Tabela 3: Pasuritë jokapitale me vlerë nën 1000 euro dhe me afat të përdorimit më shumë se një vit të KQZ-së

Pasuria e KQZ-së, e cila është regjistruar në Softuerin E-pasuria, në vitin 2014 ka vlerën prej 678,226 euro.

5 AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

5.1 Aktivitetet e përgjithshme gjatë periudhës jo zgjedhore

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është fokusuar në zbatimin e Planit të Punës dhe objektivave të planit 2014, adresimin e çështjeve që janë ndërlidhur me përgatitjet për procesin zgjedhor dhe zhvillimin e aktiviteteve të rregullta mbështetëse.

Organizimi i ditës ndërkombëtare të zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shënuar "Ditën Globale të Zgjedhjeve", e cila shënohet që nga viti 2005, në çdo të enjte të parë të muajit shkurt, ndërsa për KQZ-në kjo është hera e dyta e organizimit të kësaj ngjarjeje edhe në Kosovë.

Hartimi i planit strategjik të KQZ-së për vitin 2015 - 2018

KQZ-ja ka formuar një komisionin me qëllim të hartimit të Dokumentit strategjik, i cili identifikon, vlerëson dhe rekomandon një grup të politikave dhe veprimeve për arritjen e një prioriteti ose synimi të caktuar, për një periudhë 4 vjeçare. Duke u bazuar në experiencën që IFES ka në planifikim strategjik, ka ofruar përkrahjen në këtë drejtim.

Gjatë procesit të hartimit të Planit Strategjik, KQZ-ja ka konsultuar të gjithë stafin e brendshëm dhe akterët e jashtëm të identifikuar nga grupi punues (subjektet politike, OJQ, Institucionet, përfaqësi diplomatike)

KQZ-ja në Planin Strategjik, ka përcaktuar këto Shtylla strategjike: Operacionet zgjedhore, edukimi dhe informimi i votuesve, fuqizimi institucional, lista votuese, pjesëmarrja në zgjedhje, inovacioni dhe teknologjia, si dhe korniza ligjore.

Regjistrimi i Partive Politike gjatë vitit 2014

Në pajtim me nenin 12 të Ligjit nr. 03/l-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullën Nr. 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Zyra gjatë vitit 2014 i ka rekomanduar KQZ-së për regjistrim, nëntë (9) parti politike.

Akronimi	Emri i Partisë politike	Data e regjistrimit
KNRP	KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA	08.04.2014
PDS	PROGRESIVNA DEMOKRATSKA STRANKA	22.04.2014
PLE	PARTIA LIBERALE E EGJIPTIANE	29.04.2014
REK	REPUBLIKANËT E KOSOVËS	12.05.2014

JGP	JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	12.05.2014
PB	PARTIA E BALLIT	18.12.2014
LQV	LËVIZJA QYTETARE VATRA	18.12.2014
PG	POKRET ZA GORA	18.12.2014
PDU	PARTIA DEMOKRATIKE E UNITETIT	18.12.2014

Tabela 4: Lista e partive politike të regjistruara gjatë vitit 2014

Monitorimi i Kuvendeve të Partive Politike

Në pajtim me nenin 15.6 të Rregullës 01/2013, Zyra për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, është e obliguar të monitorojë çdo kuvend të partive politike. Gjatë vitit 2014 janë mbajtur tetë (8) kuvende të partive politike, të cilat janë monitoruar nga ZRPPC-ja, për të cilat janë përgatitur raporte të veçanta.

Nr.	Emri i partisë	Akronimi	Data e monitorimit
1.	UJEDINJENA STRANKA BOŠNJAKA	USB	03/05/2014
2.	KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA	KNRP	12/10/2014
3.	PARTIA LIBERALE E EGJIPTIANE	PLE	26/10/2014
4.	NOVA PARTIJA KOSOVA	NPK	08/11/2014
5.	PROGRESIVNA DEMOKRATSKA STRANKA	PDS	12/10/2014
6.	JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	JGP	02/11/2014
7.	NARODNA CRNOGORSKA PARTIJA KOSOVA	NCPK	21/12/2014
8.	PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	PAI	09/05/2014

Tabela 5: Kuvendet e mbajtura te PP-ve

Pezullimi i partive politike

Në pajtim me nenin 6 të Rregulles nr. 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Zyra gjatë vitit 2014 i ka rekomanduar KQZ-së, për pezullimin nga regjistri i partive të regjistruara, partinë politike, Stranka Demokratske Akcije, me akronimin SDA, për mos mbajtjen e kuvendit zgjedhor në afatin e caktuar, sipas nenit 15.1 të po kësaj rregulle. Me vendimin e KQZ-së, partia politike e pezulluar obligohet që në afat të shtuar prej dyzet e pesë (45) ditësh ta mbajë Kuvendin e saj.

Pas përmbushjes së obligimeve, partia politike, Stranka Demokratske Akcije-SDA, i është hequr masa e pezullimit dhe është kthyer në regjistrin e partive politike me date 21.03.2014

Ç'regjistrimi i Partive Politike

Sipas nenit 8.1 d) të Rregulles 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, me vendimin e KQZ-së, Zyra ka fshirë nga regjistri i partive politike tri (3) parti të cilat vullnetarisht janë shpërndarë në pajtim me statutet e tyre.
Këto parti politike, në Zyrë kanë dorëzuar tërë dokumentacionin e nevojshëm, (kërkesa me argumente dhe vendimi i organit më të lartë të partisë), gjithashtu Zyra ka kërkuar edhe nga PZAP-i që të dokumentojë se këto parti politike nuk kanë ndonjë gjobë të papaguar.

Partia politike e ç'regjistruar nga regjistri, sipas nenit 8.2 të Rregullës së lartëcituar, i pushon statusi i personit juridik dhe konsiderohet e shpërndara, ndërsa kalimi i pasurisë bëhet në pajtim me statutit e partisë.

Akronimi	Emri i Partisë politike	Data e çregjistrimit
PSK	PARTIA SOCIALISTE E KOSOVËS	14.05.2014
PPI	PARTIA E PENSIONISTËVE DHE INVALIDËVE	14.05.2014
LEK	LIDHJA E EGJIPTIANËVE TË KOSOVËS	14.05.2014

Tabela 6 : Partitë Politike të çregjistruara nga KQZ

Takimet e mbajtura me përfaqësuesit e subjekteve politike

1. Takimi me përfaqësuesit e subjekteve politike me temën "Njoftimi i Subjekteve Politike lidhur me afatet ligjore dhe procedurat për certifikim të Subjekteve Politike dhe akreditimin e vëzhguesve" është mbajtur me datë 09. 05. 2014;

2. Zyra, gjithashtu me datë 24. 06. 2014, ka organizuar trajnimin e përfaqësuesve financiar të Subjekteve Politike lidhur me Plotësimin e Raportit Financiar të Fushatës Zgjedhore. Këtë trajnim e ka mbështetur IFES-i (International Foundation for Electoral Systems) i cili ka angazhuar ekspertë të licencuar të auditimit.

Azhurnimi vjetor i të dhënave të subjekteve Politike

Të gjitha partitë politike, sipas Planit të miratuar kanë respektuar afatin ligjore dhe kanë dorëzuar azhurnimet vjetore. Ky aktivitet bazohet në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe Rregullës nr. 01/2013. Partitë politike të cilat nuk dorëzojnë ndryshimet vjetore (azhurnimet), gjobiten. Afati i dorëzimit është 31 janari i vitit vijues.

Raportet financiare të fushatës zgjedhore të subjekteve politike

Afati ligjor për dorëzimin e raporteve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale 2013, ishte 15 janari 2014. Për këtë, Zyra ka njoftuar 103 subjektet politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet lokale, lidhur me afatin ligjor për dorëzimin e Raportit Financiar të Fushatës Zgjedhore. Nga 103 subjekte politike, 90 prej tyre brenda afatit kanë dorëzuar raportin e shpenzimeve të fushatës. Zyra, për dhjetë (10) subjekte politike ka i rekomanduar KQZ-së shqiptimin e gjobave për dorëzim me vonesë të raportit të shpenzimeve të fushatës. Gjithashtu, duke u bazuar në Ligjin për Financim të SP-ve, për tri (3) subjekte që nuk kanë dorëzuar fare raport, Zyra ka njoftuar PZAP-in.

Gjobat e shqiptuara nga KQZ-ja për subjektet politike

Në pajtim me nenin 21.1 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike si dhe nenin 7.1 të Rregullës Zgjedhore nr. 12/2013 Kufizimi i Shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimi Financiar, KQZ-ja u ka shqiptuar gjobat këtyre subjekteve politike që kanë dorëzuar me vonesë raportet e deklarimit financiar të fushatës, sipas tabelës në vijim:

Nr.	Emri i subjektit politik	Akronimi	Deklarimi me vonës	Shuma e gjobave
1.	Partia e Ashkalijve për Integrim	PAI	47 ditë	3,516.45 €
2.	Crnogorska Liberalna Stranka	CLS	32 ditë	1,003.20 €
3.	Kosova Turk Adalet Partisi	KTAP	34 ditë	1,003.40 €
4.	PSD - Partia Socialdemokrate	PSD	71 ditë	1,007.10 €
5.	Narodna Pravda		77 ditë	1,007.70 €
6.	Demokratska Inicijativa		78 ditë	1,007.80 €
7.	Inicijativa za Bolji Život		81 ditë	1,008.10 €
8.	Zajedno za Lipljan		81 ditë	1,008.10 €
9.	Hysni Rexhepi		81 ditë	1,008.10 €
10.	Yll Isufi		84 ditë	1,008.40 €
		Totali:		12,577.55 €

Tabela 7 - Gjobat e shqiptuara nga KQZ-ja për dorëzim me vonesë të raporteve të deklarimit financiar të fushatë zgjedhore-2013

5.2 Buxheti dhe Financat

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organizatë buxhetore, me kod organizativ 320 dhe me kod funksional 0170. KQZ-ja financohet nga Buxheti i Kosovës . Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i organizuar ne tri programe buxhetore:

- 14100 Programi i Sekretariatit te KQZ-së i cili paraqet shpenzimet operacionale
- 14200 Programi i Zgjedhjeve i cili paraqet buxhetin e zgjedhjeve
- 10400 Programi Fondi për mbështetje demokratike

Me ligjin e Buxhetit te Kosovës numër 04/L-233 për vitin 2014, KQZ-së i është aprovuar Buxheti për tre programet në shumë prej 11,535 mijë euro, si dhe numri i aprovuar i stafit me këtë ligj ishte 88 zyrtarë.
Ne kuadër të këtij buxheti është aprovuar buxheti në programin e Zgjedhjeve në shumë prej 6,317,413 euro, i cili ishte planifikuar vetëm për zgjedhjet parlamentare, çka do të thotë se në këtë buxhet nuk janë planifikuar zgjedhjet e jashtëzakonshme për asnjë komunë.
Në fillim të vitit 2014, përkatësisht me 23 shkurt, u mbajtën zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune. Financimi i tyre është bërë nga buxheti i programit te Zgjedhjeve te KQZ-së, për vitin 2014.
Gjithashtu obligimet dhe shpenzimet e bartura nga zgjedhjet lokale të vitit 2013 u paguan nga buxheti i planifikuar për zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës.
Pas analizës së bërë të buxhetit për zgjedhje dhe duke pasur parasysh këto dy fakte, pas shpalljes së datës për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, KQZ-ja, duke u bazuar në nenin 29 te Ligjit nr. 03/L-048, ka kërkuar mjete shtesë për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës.
Kërkesa është miratuar dhe me vendimin nr. 07/189 të datës 23 maj 2014. Qeveria i ka ndarë KQZ-së buxhet shtesë në shumë prej 350,000 euro, sipas këtyre kategorive:

- 113,000 euro ne paga dhe mëditjeve dhe
- 237,000 euro mallra dhe shërbime.

Duke pasur parasysh buxhetin fillestar të aprovuar, si dhe buxhetin shtesë nga Qeveria e Republikës se Kosovës, buxheti i KQZ-së kishte vlerën prej 11,884,930 euro për të tri programet.
Në këtë buxhet është i përfshirë buxheti i:

- Programit të Sekretariatit të KQZ-së, i cili ka të bëjë kryesisht me shpenzimet operative te KQZ-së;

- Programit te Zgjedhjeve, i cili ka te bëjë me buxhetin për organizimin e Zgjedhjeve për Kuvend te Kosovës dhe
- Fondi për mbështetje demokratike, i cili ka të bëjë subvencionimin e subjekteve politike.

Zgjedhjet u mbajtën më 8 qershor 2014, në tërë territorin e Kosovës, përkatësisht ato u organizuan në 798 qendra të votimit në 2,374 vendvotime dhe për 1,782,454 votues.
Në vitin 2014, për arsye të rrethanave të krijuara, si: vonesa ne krijimin e institucioneve dhe të parlamentit të Kosovës, ka pamundësuar rishikimin e buxhetit për vitin 2014.
Megjithatë, në bazë të nenit 31 te Ligjit 03/L -048, Qeveria, organizatave buxhetore u ka shkurtuar buxhetin. Në bazë të vendimit numër 07/172 të datës 27.02.2014, kursehen shpenzimet e organizatave buxhetore ne nivelin 15 % të shumës së alokuar nga ndarja buxhetore nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve komunale për vitin 2014.
Në këtë drejtim, me vendimin numër 06/198 të datës 01.10.2014, KQZ-së i janë bërë shkurtime buxhetore në programet e Sekretariatit dhe të Zgjedhjeve, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, dhe të shpenzimeve komunale.
KQZ-së buxheti i është shkurtuar në mallra dhe shërbime në të dy programet për 972,077 euro, ndërsa në kategorinë e shpenzimeve komunale po ashtu në të dy programet buxheti është shkurtuar për 9,297 euro.
Shkurtime buxhetore u bënë edhe në kategorinë e shpenzimeve kapitale me vendimin e Qeverisë numër 01/204 te datës 05.11.2014, për të dy programet, për 41,209 euro.
Mjetet e kursyera në shumë prej 1,022,583.60 euro, Qeveria, sipas prioriteteve, i ka transferuar te organizatat e tjera buxhetore.
Rritja e pagave prej 25 % ka krijuar deficit në buxhetin paga dhe mëditje të KQZ-së. Deficitin prej 23,580 për pagat e muajit dhjetor e ka mbuluar Qeveria me vendimin 07/03 te datës 19.12.2014.
Pasi u caktua data e mbajtjes të zgjedhjeve te jashtëzakonshme për kryetar komune të Graçanicës, Qeveria, KQZ-së i ka ndarë buxhet për organizimin e këtyre zgjedhjeve në shumë prej 181,817 euro sipas këtyre kategorive ekonomike:

- Paga dhe mëditje 27,152 euro
- Mallra dhe shërbime 153, 065 euro dhe
- Shpenzime komunale 1,600 euro

Pasi kishin përfunduar të gjitha procedurat e zotimeve dhe shpenzimeve të mjeteve si dhe ishim në fund të vitit fiskal, buxheti i ndarë për këto zgjedhje ishte e pamundur të shpenzohet. Pasi buxheti i ndarë për këtë qëllim nuk është shpenzuar, KQZ-ja ka kërkuar që ky buxhet të bartet në vitin 2015. Në fund të vitit fiskal 2014, KQZ-ja kishte buxhetin në shumë prej 11,067,742 euro.
Aktivitetet ne Divizionin e buxhetit dhe financave për vitin qe lamë pas, kanë konsistuar në

përgatitjen e dokumenteve strategjike, si Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, si dhe përgatitja e buxhetit për vitin fiskal 2015, realizimi i planit të të hyrave dhe monitorimi me kujdes i shpenzimit të buxhetit.
Prioritet dhe aktivitet kryesor ishte zotimi i mjeteve dhe pagesa e të gjitha obligimeve dhe shpenzimeve, të cilat ishin të lidhura drejtpërdrejt me procesin e Zgjedhjeve te Parakohshme Parlamentare 2014.

Kategoritë ekonomike	Buxheti vjetor	Buxheti i rishikuar	Buxheti përfundimtar	Buxheti i Shpenzuar	% Buxheti i shpenzuar
	A	B	C	D	E=D/A*100
Paga dhe Mëditje	582,937	163,732	746,669	719,517.24	96.36%
Mallra &Shërbime	6,480,513	(582,012)	5,898,501	4,472,974.34	75.83%
Shpenzimet Komunale	61,980	(7,697)	54,283	41,460.35	76.38%
Subvencione dhe transfere	4,200,000	0	4,200,000	4,160,674.48	99.06%
Shpenzimet Kapitale	209,500	(41,210)	168,290	107,242.00	63.72%
Totali	**11,534,930**	**(467,186)**	**11,067,744**	**9,501,868.41**	**85.85%**

Tabela 8: Buxheti i planifikuar dhe shpenzuar janar- dhjetor 2014

Buxheti i planifikuar i KQZ-së për vitin 2014 në shumë prej 11,067,744 € ka këtë strukturë buxhetore:

- 6.75 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje,
- 53.29% të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime,
- 37.95% të fondeve për subvencione dhe transfere
- 0.49% për shpenzimet komunale dhe
- 1.52% të fondit për shpenzime kapitale.

Në vitin 2014, KQZ-ja ka shpenzuar 9,501,868.41 euro të buxhetit të planifikuar për vitin 2014, përkatësisht buxheti i planifikuar është shpenzuar 85,85%.
Shprehur në përqindje, sipas kategorive ekonomike, KQZ-ja ka shpenzuar buxhetin me te strukturë:

Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve buxheti i planifikuar u shpenzua 96.36%, në mallra dhe shpenzime buxheti u shpenzua 75.83%, shpenzimet komunale u shpenzuan 76.38%, shpenzimet subvencione dhe transfere buxheti u shpenzua 99.06% dhe buxheti për shpenzime kapitale u shpenzua 63.72%. Ndërkaq vlera nominale e buxhetit te shpenzuar duket sipas tabelës me titull Buxheti i Planifikuar dhe shpenzuar, janar-dhjetor 2014 ne kolonën D.



Menaxhimi i fondeve të akorduara për Komisionin Qendror te Zgjedhjeve është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet, duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv. Zhvillimi i tenderëve të hapur, si dhe formave të tjera tenderuese, ka arritur të plotësojë nevojat për material zgjedhor sipas specifikave dhe cilësisë së kërkuar.

Paga dhe mëditje

Buxheti i aprovuar në paga dhe mëditje ishte në shumë prej 582,937 euro. Mirëpo në buxhetin e vitit 2014 në këtë kategori ka pasur ndryshime të cilat kanë reflektuar në total buxhetin e vitit 2014. Për arsye të angazhimeve dhe aktiviteteve shtesë në proces zgjedhor është zgjatur orari i stafit të KQZ-së dhe është punuar me shumë se dhjetë orë në ditë, duke mos i përjashtuar ditët e vikendit dhe ditët e festave zyrtare e shtetërore.

Me vendimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës nr. 07/189 te datës 23 maj 2014, përmes së cilit është aprovuar kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KQZ-së i janë ndarë mjete në shumë prej: 113,000.00 euro në kategorinë e Pagave dhe mëditjeve ne programin e Sekretariatit (14100).

Rritja e pagave prej 25% ka krijuar deficit në buxhetin paga dhe mëditje të KQZ-së. Deficitin prej

23,580 për pagat e muajit dhjetor e ka mbuluar Qeveria me vendimin 07/03 të datës 19.12.2014. Pasi u caktua data e mbajtjes të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune të Graçanicës, Qeveria, KQZ-së i ka ndarë buxhet në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje 27,152 euro

Buxheti në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitin 2014 ishte në shumë prej 746,669 euro. Ky buxhet është shpenzuar në vlerë prej 719,517.24 euro apo shprehur në përqindje, buxheti në kategorinë e pagave dhe mëditjeve është shpenzuar për 96.36%.

Mallrat dhe shërbimet

Buxheti për mallra dhe shërbime, në bazë të Ligjit nr. 04/L-233, për të dy programet ishte në vlerë prej 6,480,513€. Buxheti i planifikuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për Sekretariatin e KQZ-së, përkatësisht për shpenzime operacionale, është në shumë prej 320,000€, ndërsa për Programin e Zgjedhjeve i cili buxhet kryesisht ka të bëjë me procesin e Zgjedhjeve Parlamentare 2014, ishte ne vlerë prej 6,160,513€.

Gjatë vitit 2014, për te dy programet e KQZ-së (Sekretariati dhe Zgjedhjet), buxheti i kategorisë së mallrave dhe shpenzimeve është shpenzuar 75.83%, e që kryesisht këto shpenzime kanë të bëjnë me mbajtjen dhe organizimin e zgjedhjeve.

Buxheti i aprovuar dhe shpenzuar i programit të Zgjedhjeve të KQZ-së i vitit 2014 sipas kategorive ekonomike, duket kështu:

Kategoritë	Buxheti aprovuar 2014	Buxheti i shpenzuar 2014	Shpenzimet në, %
Gjithsej buxheti	6,430,413.00	4,436,088.66	68.99%
Pagat dhe mëditjet	113,000.00	113,000.00	100.00%
Mallrat dhe Shërbimet	6,160,513.00	4,248,595.17	68.96%
Shpenzimet Komunale	22,700.00	12,503.09	55.08%
Investimet Kapitale	134,200.00	61,990.40	46.19%

Tabela 9: Buxheti i aprovuar dhe shpenzuar në Zgjedhjet Parlamentare 2014

Realizimi i buxhetit në vitin 2014 i Programit te Zgjedhjeve kundrejt planit është bërë në masën 68.99%, pra nga 6,4 milionë euro të buxhetit të aprovuar për Zgjedhjet Parlamentare, janë shpenzuar 4,4 milionë euro. Fondet e mbetura të pashfrytëzuara të buxhetit në vitin 2014 kryesisht kanë të bëjnë me kategorinë buxhetore të mallrave dhe shërbimeve.

Në totalin e shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve, në pjesëmarrje më të lartë ka realizuar kategoria e Shërbimeve kontraktuese tjera, çka do të thotë se u shpenzuan 4,248,595.17€.

Stafi jopermanent, Këshillat Komunale Zgjedhore (KKZ), stafi tjetër i angazhuar ne Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve, si dhe anëtarët e Këshillave te vendvotimeve (KVV-të) së bashku me personelin tjetër ndihmës, janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, përkatësisht nga shërbimet kontraktuese tjera.

Përshkrimi	**Stafi i angazhuar**	**Pagesa € (ne euro)**
KKZ-të e angazhuar	259	256,901.12
Stafi jo permanent	286	232,859.88
Trajnerë	301	236,786.55
Anëtarë të KVV-ve	23,088	1,536,357.00
QNR (stafi ne numërim, në projektin K-Vote dhe Stafi për aplikacione OVPP	1,785	272,222.00
Total	25,719	2,535,126.55

Tabela 10: Stafi i angazhuar në Zgjedhjet e parakohshme Parlamentare 2014 dhe pagesa e tyre

Vetëm për stafin e angazhuar në proces zgjedhor u shpenzuan 2,535,126.55 euro, e të cilat përmbajnë 60 % të shpenzimeve të realizuara në buxhetin e mallrave dhe shërbimeve.
Ndërsa mjetet tjera të shpenzuara në shuma më të mëdha, kanë të bëjnë me shpenzimet e operacioneve zgjedhore, si: prodhimin e fletëvotimeve, shërbimi votues, shpenzimet për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, material zgjedhor, shpenzimet për material te trajnimit, qiraja për depo dhe informimi publik.
Shpenzimet e tjera kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e veturave dhe shpenzimet e derivateve, internetit, sigurimit fizik te objektit të QNR-se dhe të depos, shpenzimet e telefonisë mobile për menaxherët e qendrave të votimet dhe shpenzime të tjera operacionale.

Shpenzimet komunale

Shpenzimet komunale janë planifikuar për vitin 2014 për programin e Sekretariatit KQZ-së dhe të Zgjedhjeve në vlere prej 54,283.00€, të cilat janë shpenzuar në vlere prej 41,460.35€. Këto kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e telefonisë fikse, energjisë elektrike dhe mbeturina.

Subvencione dhe transfere

Me Ligjin nr. 04/L-233 për Buxhetin e Republikës se Kosovës për vitin 2014, buxheti i aprovuar për programin Mbështetje e Subjekteve Politike (10400) ishte ne shume prej 4,200,000 euro. Gjate vitit 2014 subjektet politike nga buxheti subvencioneve kanë shpenzuar buxhetin në shumë prej 4,160,674.48 euro apo buxhetin e planifikuar e kanë shpenzuar 99.06%.

Nr.	Kodi Programit	Subjekte Politike	Nr.vendeve mandati i ri	Planifikimi i buxhetit	Shuma e paguar	% e realizimit
1	10402	PDK	37	1,118,250.00	1,118,250.00	100%
2	10401	LDK	30	921,375.00	921,375.00	100%
3	10427	VETVENDOSJE	16	484,750.00	484,749.95	100%
4	10403	AAK	11	372,750.00	372,750.00	100%
5	10432	SRPSKA LISTA	9	141,750.00	141,750.00	100%
6	10433	NISMA	6	94,500.00	94,500.00	100%
7	10407	KDTP	2	78,750.00	78,750.00	100%
8	10406	VAKAT	2	64,750.00	64,750.00	100%
9	10416	PDAK	1	32,375.00	32,375.00	100%
10	10430	PAI	1	33,250.00	33,249.98	100%
11	10431	NDS	1	32,375.00	32,374.99	100%
12	10434	PDS	1	15,750.00	15,750.00	100%
13	10435	PLE	1	15,750.00	15,750.00	100%
14	10436	KZA	1	15,750.00	15,750.00	100%
15	10437	KNRP	1	15,750.00	15,750.00	100%
16	10428	KKR-8		133,000.00	132,999.98	100%

17	10420	SLS-8		133,000.00	132,999.98	100%
18	10429	JSL-4		70,000.00	69,999.98	100%
19	10421	SDSKIM-1		17,500.00	17,499.98	100%
20	10426	BSDAK-1		17,500.00	17,499.98	100%
21	10409	IRDK-1		16,625.00	16,624.99	100%
22	10414	GIG-1		16,625.00	16,624.99	100%
23	10413	PRBK-1		15,750.00	15,750.00	100%
		Totalet	**120**	**3,857,875.00**	**3,857,874.80**	**100%**

Tabela 12 : Buxheti për programin Mbështetje e Subjekteve Politike

Ne vitin 2014 për zhvillimin e aktiviteteve të grupeve parlamentare janë planifikuar 342,125.00 euro. Nga këto mjete u shpenzuan 302,799.70 euro apo buxheti i planifikuar u shpenzua 88.51%.

Nr.	Kodi Programit	Grupi Parlamentar	Nr.vendeve mandati i ri	Planifikimi i buxhetit	Shuma e paguar	% e realizimit
1	10452	PDK	37	124,250.00	106,921.16	86.05%
2	10451	LDK	30	76,125.00	58,405.41	76.72%
3	10462	VETVENDOSJE	16	40,250.00	40,206.86	99.89%
4	10453	AAK	11	30,625.00	29,960.21	97.83%
5	10463	KKR (8)		8,750.00	8,214.20	93.88%
6	10460	SLS (8)		7,875.00	7,865.75	99.88%
7	10461	6+	6	19,250.00	18,170.87	94.39%
8	10464	SRPSKA LISTA	9	15,750.00	15,713.52	99.77%
9	10465	NISMA	6	10,500.00	10,444.04	99.47%
10	10475	PDS	1	1,750.00	1,740.00	99.43%
11	10476	PAI	1	1,750.00	1,730.72	98.90%
12	10477	NDS	1	1,750.00		0.00%

13	10472	PLE	1	1,750.00	1,734.20	99.10%
14	10478	KZA	1	1,750.00	1,692.76	96.73%
		Totali	**120**	**342,125.00**	**302,799.70**	**88.51%**

Tabela 13 :Buxheti i planifikuar për Grupet Parlamentare dhe shpërndarja e mjeteve për vitin 2014

Gjatë vitit 2014, shuma prej 5,205 euro janë mjete të shpenzuara në fund te vitit 2014 dhe këto nuk kanë arritur të derdhen në llogarinë e përfituesit. Këto mjete tani regjistrohen si të hyra në vitin 2015 në buxhetin e Kosovës të cilin regjistrim e bën Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Financave. Informata tjera shtesë janë në tabelën më poshtë.

Data e kthimit	Ref. Kthimit	Shuma e pagesës	Arsyeja për refuzim	Numri i Kuponit Shpenzimit
5-Jan-15	000PCIN150050270	1,734.20	417096 2014002 32014178 SUBV GP PERFPLETI GRUPI PARLAMENTAR PLE(KTHIM DT:31.12.2014 LLOG E PERF E MBYLLUR	417096
5-Jan-15	000PCIN150050271	1,740.00	418035 2014003 32014175 SUBVGP PDSPAISJTI GRUPET PARLAMENTARE PDS(KTHIM DT:31.12.2014 LLOG E PERF E MBYLL	418035
5-Jan-15	000PCIN150050272	1,730.72	421189 2014001 32014176 SUBVGP PAITI PAISJ GRUPET PARLAMENTARE PAI(KTHIM DT:31.12.2014 LLOG E PERF E MBYL	421189
Gjithsej		**5,204.92**		

Tabela 14: Kthimet e mjeteve të tri grupeve parlamentare në Llogarinë e Vetme të Thesarit në BQK.

Paraqitja grafike e subvencioneve te planifikuara dhe të shpenzuara për subjektet politike



Shpenzimet kapitale

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për investime kapitale ka planifikuar buxhetin në shumë prej 168,290€. Këto mjete janë planifikuar për blerjen e Softuer-ve për numrin te votave Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, K-Vote dhe Furnizim me pajisje të TI-ë, kompjuterë për stafin e KQZ-së dhe SKQZ-së. Për këto qëllime, në vitin 2014 u investuan 107,242€, apo 63.72% e buxhetit të planifikuar.

Të hyrat vetanake

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve realizon të hyra nga subjektet politike në shumë prej 33,920 euro. Këto të hyra realizohen në formë të depozitave me rastin e certifikimit të subjekteve politike për pjesëmarrje në proces zgjedhor ose nga gjobat e shqiptuara nga KQZ-ja, si dhe nga tarifat administrative. Në vitin 2014, të hyrat nga depozitat janë 29,520€. Ndërsa depozitat e subjekteve politike ishin në shumë prej 4,400 euro, e cila shumë do të bartet në vitin 2015. Subjektet politike duhet të plotësojnë dokumentet përkatëse për transfer.

Obligimet e bartura për vitin 2015

Obligime të papaguara të KQZ-së në vitin 2014 janë në shumë prej 20,457 euro, prej të cilave 5,100.85 euro kanë të bëjnë me kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa 15,356.15 euro me shpenzimet komunale. Te shpenzimet komunale vlen të theksohet se fatura e shpenzimeve të energjisë elektrike për tërë ndërtesën ku është e vendosur KQZ-ja, është shpenzim i muajit dhjetor me vlerë prej 12,700.47 euro. Obligimet e papaguara në të dy kategoritë kane të bëjnë

kryesisht me faturat të cilat kanë arritur pas zotimit të mjeteve ose me shërbimet të cilat janë realizuar në fund të dhjetorit e faturat kanë arritur në janar të 2015.

5.3 Prokurimi

Plani i prokurimit për vitin 2014, është përgatitur dhe është dorëzuar në Autoritetin Qendror të Prokurimit. Ky plan është përgatitur në bazë të rrjedhës së parasë dhe kërkesave të njësive kërkuese. Planifikimi i mbajtjes së zgjedhjeve për vitin 2014, ka ndikuar edhe në vëllimin e punëve të prokurimit.

Në bazë të kërkesave të njësive, në planin final të prokurimit janë planifikuar mjete për të dy programet. Për programin zgjedhor dhe jo zgjedhor ka qenë të planifikuara 1,838,007.50€, ndërsa janë shpenzuar mjete në shumë prej 1,373,532.50€.

Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit janë përdorë procedura të hapura, procedura të negociuara, si dhe procedura me afate te përshpejtuara konform Ligjit të prokurimit në fuqi.

Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës,	Çmimi i Aneks kontratës
Sigurimi kasko i automjeteve dhe kontrollimi teknik	03.02.2014	6,000.00	5,893.05	0.00
Shtypja e listave përfundimtare dhe listave komunale për zgjedhjet e jashtëzakonshme ne Mitrovicën e Veriut	03.02.2014	1,200.00	355.10	0.00
Rregullimi I automjeteve të huazuara nga MAPL dhe FSK për zgjedhjet lokale 2013	07.02.2014	1,600.00	1,568.00	0.00
Shtypja e bexhave për zgjedhjet ne Mitrovicën e Veriut	10.02.2014	2,700.00	463.50	0.00
Asgjësimi i materialit sensitiv te zgjedhjeve lokale 2013	04.02.2014	3,000.00	997.50	0.00
Zhvillimi i softuerit për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Mitrovicën e Veriut	21.02.2014	5,500.00	968.60	0.00
Furnizim me vula	29.01.2014	100.00	94.50	0.00
Furnizim me Kuti Votimi	23.09.2014	125,000.00	123,883.00	0.00

Shtypja e Doracakut të trajnimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Mitrovicën e Veriut	05.02.2014	800.00	790.00	0.00
Shtypja e shablloneve të BRAILL - it për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Mitrovicën e Veriut	30.01.2014	502.00	286.00	0.00
Shtypja e Formave zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme ne Mitrovicën e Veriut	10.02.2014	2,000.00		0.00
Shtypja e banerave, broshurave dhe ftesave për ditën globale të zgjedhjeve	31.01.2014	850.00	596.00	0.00
Shtypja e Fletëvotimeve	13.02.2014	6,500.00	3,228.09	0.00
Larja e Veturave të SKQZ - së brenda dhe jashtë	01.03.2014	990.00	775.50	0.00
Shërbimet e Internetit për KKZ dhe SKQZ	27.04.2012	6,680.00	2,358.86	0.00
Shërbimet e Internetit për KKZ dhe SKQZ	02.04.2014	13.360.00	3,203.17	0.00
Furnizim me lidhëse të Sigurisë për kuti votimi	14.04.2014	70,000.00	12,000.00	0.00
Furnizim me letër A4 dhe A3 për KQZ dhe SKQZ	15.04.2014	30,000.00	10,903.57	0.00
Shtypja e dinstiktive për stafin Q.V dhe V.V	19.05.2014	80,575.00	66,524.28	0.00
Furnizim me material administrativ	07.07.2014	22,550.00	3,094.00	0.00
Furnizim me material administrativ	13.04.2012	9,285.50	11,098.20	0.00
Furnizimi me tonera	19.05.2014	30,000.00	28,836.00	0.00
Shtypja e Fletëvotimeve dhe broshurave	19.05.2014	185,000.00	168,374.17	0.00
Informimi Publik	15.05.2014	472,300.00	302,663.79	0.00
Furnizim me UV Sprej	21.05.2014	50,000.00	43,204.32	0.00
Furnizim me UV llampa	19.05.2014	25,000.00	21,044.40	0.00
Furnizim me material administrativ për pakot e vendvotimeve	20.05.2014	50,000.00	38,289.00	0.00

Furnizim me Vula dhe Jastëk të Vulave	19.05.2014	16,000.00	14,400.00	0.00
Furnizim me Bateri 1.5V AA	20.05.2014	25,000.00	15,256.60	0.00
Furnizim me pakot e trajnimit	22.05.2014	50,000.00	41,964.79	0.00
Furnizim me doracak te trajnimit	19.05.2014	30,000.00	9,180.00	0.00
Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	19.05.2014	45,300.00	45,251.60	0.00
Furnizim me Format Zgjedhore	22.05.2014	98,940.00	90,000.00	8,940.00
Aplikacionet për regjistrim te votimit jashtë vendit	13.05.2014	4,000.00	3,500.00	0.00
Furnizim me Zarfa	14.05.2014	21,000.00	10,400.00	0.00
Transporti i materialit sensitiv dhe josensitv	22.05.2014	30,000.00	28,854.35	0.00
Transporti i stafit në QNR	20.05.2014	16,000.00	10,299.96	0.00
Modifikimi I Softuerit	22.05.2014	62,000.00	61,990.40	0.00
Sigurimi I detektorëve ne QNR	20.05.2014	4,500.00	1,511.90	0.00
Riparimi dhe Servisimi i dyerve Hidraulike ne QNR	21.05.2014	950.00	939.00	0.00
Furnizim me HARD - DISQE në QNR	20.05.2014	750.00	695.00	0.00
Servesimi i aparateve te zjarrit	20.05.2014	850.00	689.00	0.00
Furnizim me DVR për kamerat e siguri	19.05.2014	750.00	600.00	0.00
Shtypja e listave përfundimtare dhe listave komunale	22.05.2014	69,000.00	54,973.08	0.00
Furnizim me Kabina të Votimit	21.05.2014	45,000.00	26,120.00	0.00
Shtypja e shablloneve të BRAILL - it	27.05.2014	29,990.00	29,772.00	0.00
Furnizim me Ujë të pijes	11.06.2014	9,000.00	2,800.00	0.00
Riparimi i rrymës dhe servisimi i gjeneratorit në QNR	27.05.2014	450.00	440.00	0.00
Blerja e Kondicionerëve të Air - it	06.06.2014	998.00	978.00	0.00
Blerja e tavolinave ne QNR	06.06.2014	998.00	975.00	0.00
Furnizim me ventilator për zyre	06.06.2014	400.00	300.00	0.00

Pastrimi (Higjena) në objekt. e SKQZ-së	07.10.2014	12,844.00	12,737.26	0.00
Asgjësimi i materialit në procedurë	01/08.2014	1,000.00	997.50	0.00
Furnizimi dhe mirëmbajtja e objek. të SKQZ	25.11.2014	3,000.00	0.00	0.00
Furnizimi me ormanë metalik dhe rafte	04.12.2014	6,000.00	3,085.00	0.00
Furnizimi ne telefona	08.12.2014	5,885.00	5,610.00	0.00
Furnizimi me Llap-topa	22.12.2014	26,300.00	21,819.60	0.00
Shërbimet e udhëtimit jashtë vendit	12.07.2012	15,000.00	6,908.86	0.00
Servisimi i automjeteve	25.11.2013	17,000.00	9,110.00	0.00
Blerja e librave për bibliotekën e KQZ -së	08.12.2014	970.00	941.00	0.00
TOTALI :		1,838,007.50	1,364,592.50	8,940.00
TOTALI (10+11) :			**1,373,532.50**	

Tabela 15: Raporti vjetor për kontratat i dorëzuar ne KRPP

5.4 Auditimi i Brendshëm

Plani vjetor i auditimit është përgatitur dhe i njëjti është aprovuar nga KQZ-ja. Për të gjitha auditimiet e kryera janë përgatitur planet e angazhimit (planet e zhvillimit të detyrës së auditimit). Menaxhmenti dhe stafi i SKQZ-së gjatë zbatimit të të gjitha detyrave audituese kanë treguar një nivel shumë të lartë të bashkëpunimit në ofrimin e informatave të nevojshme, por edhe të diskutimit të gjetjeve. Të gjitha raportet e përgatitura janë aprovuar nga kryeshefi ekzekutiv i SKQZ-së dhe u janë shpërndarë menaxhmentit të linjave dhe të gjithë menaxhmentit të lartë. Moskonstituimi i Komitetit të auditimit si trup e KQZ-së, ka qenë njëra nga mungesat e AB-së, që ka penguar përcjelljen e aktiviteteve dhe raporteve të AB-së në KQZ. Ky komitet do të rriste përgjegjësitë e AB-së por edhe do të mundësonte kontrollin dhe monitorimin e punës së AB-së. Si AB mendoj se është përmbushur në nivel të kënaqshëm plani vjetor i auditimit për vitin 2014 dhe janë arritur përmirësime të caktuara në kontrollin e brendshëm dhe në menaxhim. Ky është vlerësim edhe i menaxhmentit të SKQZ-së por edhe i Auditorit gjeneral.

Aktivitetet e zhvilluara nga auditimi i brendshëm

Të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë procesit të auditimit të brendshëm kanë qenë në funksion të arritjes së qëllimit të auditimit për të vlerësuar nëse kontrolli i brendshëm dhe menaxhimi kanë qenë në funksion të arritjes së objektivave të KQZ-së. Më konkretisht, të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga auditimi përmblidhen si në vijim:

Aktivitete të rregullta

Auditimi i projektit K-vote- 6 rekomandime;
Auditimi i sistemit të pagesave për stafin e futjes së rezultateve në sistemin K-vote-2 rekomandime;
Auditimi i procesit zgjedhor 2014 - 6 rekomandime dhe
Auditimi i zyrës së prokurimit -5 rekomandime

Auditime me kërkesë

Auditimi i tjetërsimit të pasurisë - 1 rekomandim dhe
Auditimi i udhëtimeve zyrtare jashtë vendit- 4 rekomandime

Auditori i Brendshëm konkludon se është se në kontrollin e brendshëm dhe në menaxhim në përgjithësi, ka pasur përmirësime, por këto përmirësime janë proces që duhet në vazhdimësi të bëhen dhe të adresohen dobësitë.

6 AKTIVITETET GJATË PERIUDHËS ZGJEDHORE

Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të planifikuara të mbahen në fund të vitit, janë mbajtur me 8 qershor 2014. Gjithashtu, me vendim te Presidentes më 23 shkurt te vitit 2014 janë mbajtur Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Mitrovicën e Veriut. Këto rrethana të reja të krijuara, kanë detyruar KQZ-në të bëjë formatimin e aktiviteteve të planifikuara, duke ngjeshur kohëzgjatjen e aktiviteteve mbështetëse dhe rritur vëllimin e angazhimit ne raport me afatet e reja kohore. Afati i shkurtër për organizimin e zgjedhjeve ishte sfidë e madhe. Mirëpo, përkundër këtij fakti, organizimi i Zgjedhjeve të parakohshme është vlerësuar se ka përmbushur standardet dhe praktika me të mira ndërkombëtare dhe ka krijuar një standard te ri në organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor ne Kosovë.

6.1 Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2014

Në bazë të Ligjit për Zgjedhje, Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës janë planifikuar të mbahen ne fund të vitit 2014, rrjedhimisht edhe KQZ-ja në planin e punës për vitin 2014 si qellim kryesor ka vendosur organizimin e procesit zgjedhor.

Si rezultat i shpërbërjes se Kuvendit të Kosovës, me 8 maj, Presidentja e Republikës së Kosovës ka dekretuar datën 8 qershor si datë të mbajtjes së Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në kuadër të kompetencave kushtetuese ka ndërmarrë të gjithë hapat ligjorë për përgatitjen e parakohshme të zgjedhjeve parlamentare, me të vetmin qëllim që këto zgjedhje të jenë fer, të lira, demokratike dhe sipas standardeve ndërkombëtare.

Bazuar në Planin e Punës së KQZ-së, Sekretariati ka hartuar Planin Operacional për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2014.
Afati i shkurtër për organizimin e zgjedhjeve ishte sfide e madhe, mirëpo përkundër këtij fakti, organizimi i zgjedhjeve të parakohshme është vlerësuar se ka përmbushur standardet më të larta ndërkombëtare dhe ka krijuar një standard te ri në këtë dimension.
Planifikimi i aktivitete në raport me proceset zgjedhore të kaluara është dukshëm me i mirë, i cili ka ndikuar në kualitetin e përmbushjes se tyre, duke mundësuar formatimin bazuar me kohën dhe nevojën.

Me poshtë janë paraqitur aktivitetet dhe detyrat e realizuara që përfshijnë të gjitha aktivitetet që

rrjedhin si obligimi ligjor, aktivitetet operacionale dhe teknike nga të gjitha njësitë në funksion të organizimit të zgjedhjeve të parakohshme në Republikën e Kosovës, të mbajtura me 8 qershor 2014.

Aktivitet kryesore zgjedhore të realizuara janë, si në vijim:

- - Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i kandidatëve të tyre,
- - Shërbimi i votuesve,
- - Operacionet në terren,
- - Informimi i votuesve,
- - Trajnimi i Këshillave të Vendvotimeve,
- - Numërimi dhe Publikimi i Rezultateve,
- - Rekrutimi i zyrtarëve të përkohshëm në SKQZ-së,
- - Shpërndarja e materialit zgjedhor

6.1.1 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve

Në pajtim me Legjislacionin, deri më datë 16.05.2014, i cila ka qenë edhe afati i fundit i përcaktuar, ZRPPC-ja ka pranuar aplikacionet e tridhjetë e një (31) Subjekteve Politike për tu Certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 8 qershorit 2014. Pas aplikimit, një subjekt politik ka tërhequr aplikimin e tij.
Pas pranimit të aplikacioneve të Subjekteve Politike për Certifikim, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim brenda afatit ligjor të përcaktuar me planin operacional për Zgjedhjet e Parakohshme, ka shqyrtuar dhe verifikuar dokumentacionin e Subjekteve Politike për certifikim.
Lidhur me ketë, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim i ka rekomanduar Komisionit
Qendror Zgjedhor, certifikimin e tridhjetë (30) Subjekteve Politike me gjithsejtë njëmijë e dyqind e tridhjetë e pesë (1235) kandidatë, për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 8 qershor 2014. Prej të cilave: tetëmbëdhjetë (18) Parti Politike, shtatë (7) Nisma Qytetare, katër (4) Koalicione, dhe një (1) Kandidat i Pavarur.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim gjatë kësaj periudhe i është drejtuar Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa lidhur me informimin e Zyrës për Subjektet Politike dhe kandidatët që kanë gjoba të shqiptuara, ende të pashlyera nga PZAP-ja. Me ç'rast, PZAP-i i ka

ofruar Zyrës emrat e Subjekteve Politike dhe personave që kanë gjoba të pashlyera nga vendimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Pas përmbylljes së procesit të certifikimit të Subjekteve Politike, me datë 16 maj 2014 është mbajtur hedhja e shortit, ku përfaqësuesit e tridhjetë (30) subjekteve politike të certifikuara për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, kanë tërhequr shortin për renditjen e subjekteve të tyre ne fletëvotimin e Zgjedhjeve të Parakohshme 2014.

6.1.2 Akreditimi i vëzhguesve

Pas shqyrtimit të aplikacioneve për akreditim, KQZ- ka akredituar 36,043 vëzhgues për monitorimin e Procesit zgjedhor.

Nr i Subjekteve	Lloji i Subjektit	Nr i vëzhguesve të akredituar
16	Parti Politike	16,204
6	Nisma Qytetare	8430
4	Koalicione	7058
16	Misione Diplomatike dhe Zyra ndërlidhëse	194
4	Organizata Ndërkombëtare	197
1	Institucione vendore	49
16	OJQ-vendore	3531
34	Shtëpi Mediatike	358
	Gjithsej:	36,043

Tabela 16. Numri i organizatave dhe vëzhguesve të akredituar

6.1.3 Raportimi Financiar i Fushatës Zgjedhore

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), ka njoftuar të gjitha Subjektet Politike të Certifikuara për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 8 qershor 2014, se duhet të dorëzojnë Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës, jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve. Në pajtim me nenin 4.1 dhe 4.2 të Rregullës Zgjedhore Nr. 12/2013 - Kufizimi i Shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimi Financiar, tridhjetë (30) subjektet politike kanë dorëzuar raportet brenda afatit ligjor, siç janë:

a) (18) parti politike;
b) (4) koalicione;
c) (7) iniciativa qytetare dhe
d) (1) kandidat i pavarur

Kthimi i pagesave te certifikimit

Zyra ka proceduar brenda afatit ligjor kthimin e mjeteve të pagesës për certifikim për shtatë (7) subjekte politike të cilat kanë fituar ulëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me shumën totale: 14,000 € .

Nr.	Emrat e Subjekteve Politike	Shuma në €
1	Koalicioni -PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK &PARTA E DREJTËSISË - PD &LËVIZJA PËR BASHKIM – LB & PARTIA KONSERVATORE E KOSOVËS – PK& PARTA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS – PSHDK	2,000 €
2	NISMA PËR KOSOVËN	2,000 €
3	PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE	2,000 €
4	SRPSKA LISTA	2,000 €
5	PROGRESNIVA DEMOKRATSKA STRANKA	2,000 €
6	KOALICIJA ZA GORA	2,000 €
7	KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA	2,000 €

Tabela 17: Kthimi i depozitave të certifikimit

6.1.4 Lista Përfundimtare e Votuesve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve krijon dhe mbanë listën e votuesve, e cila përmban:

- Ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë të regjistruar si qytetarë të Kosovës sipas ligjit për shtetësinë, dhe

- Të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë Kosovës, të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës.

Gjatë procesit të krijimit të listës së votuesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 8 qershor 2014, Lista e votuesve ka kaluar nëpër dy periudha të verifikimit dhe konfirmimit të Listës së Votuesve nga ana e publikut, ashtu siç edhe përcaktohet me Ligjin për Zgjedhjet e përgjithshme dhe Rregullat Zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Periudha e Shërbimit të Votuesve për Ndërrimin e Qendrave të Votimit dhe në Planin Operacional për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Periudha e Shërbimit të Votuesve është realizuar nga data 14 maj 2014 deri me datën 24 maj 2014, ku votuesit përgjatë kësaj periudhe kanë pasur mundësi të informohen se në cilën Qendër të Votimit janë caktuar të votojnë dhe mundësinë që të kërkojnë ndërrimin e Qendrës së Votimit. Përgjatë kësaj periudhe, në zyrat e Komisioneve Komunale Zgjedhore, janë parashtruar 6 275 kërkesa për ndërrimin e qendrave të votimit, ku pastaj të gjitha ndryshimet janë përfshirë në Listën e Votuesve.
Me qëllim të informimit të Votuesve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka publikuar listën e Votuesve në ueb-faqen e saj, gjegjësisht në makinën kërkuese, ku votuesit kanë pasur mundësi të njoftohen se në cilat qendra të votimit janë caktuar të votojnë. Gjatë kësaj periudhe, makinën kërkuese e kanë vizituar 59 451 persona.
Gjatë Periudhës së Sfidimit dhe Kundërshtimit, ashtu siç edhe përcaktohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullën Zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Lista e Votuesve vihet në dispozicion të publikut, me qëllim që votuesit me të drejtë vote të kenë mundësi të kundërshtojnë pasaktësitë ose lëshimet në Listën e Votuesve duke kërkuar korrigjim ligjor në gjykatën e shkallës së parë.
Periudha e Sfidimit dhe Kundërshtimit të Listës së Votuesve është mbajtur nga data 23 maj 2014 deri me datën 24 maj 2014, ku gjatë kësaj kohe nuk ka pasur kërkesa për kundërshtim të Listës së Votuesve në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV 2014) për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2014 bazohet në Ekstraktin e Regjistrit Civil. Ky ekstrakt është përpiluar nga Agjencia e Regjistrimit Civil, gjegjësisht Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve (DPA), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
Lista Përfundimtare e Votuesve 2014 ka përmbajtur 1 782 454 emra të votuesve të ndarë në tridhjetë e tetë (38) komuna, me një rritje prej 3 097 votues apo 0.17 % në krahasim me zgjedhjet e kaluara (Zgjedhjet Lokale 2013). Numri i Qendrave të Votimit (QV) ka qenë 798, ndërsa numri i vendvotimeve ka qenë 2 374, me një rritje prej 8 vendvotimeve apo 0.59 % nga zgjedhjet e kaluara (Zgjedhjet Lokale 2013).
Votuesit e rinj që kanë pasur mundësinë për të votuar për herë të parë në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 8 Qershorit 2014, kanë qenë 33 735 votues.

- 21 545 votues të rinj që pas zgjedhjeve të vitit 2013 kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe që kanë pasur mundësinë që të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 8 Qershor 2014,

- 12 190 votues që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve të 2013-ës, e që mund të konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil midis dy palë zgjedhjesh.

Emrat e personave të vdekur dhe atyre që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës, ka qenë: 27,304.

- 20 192 emra të personave të vdekur, (që janë larguar) dhe

- 7 112 emra të personave që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës.

Pra, të dhënat me emrat e personave të vdekur me të drejtë vote dhe numri i atyre që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës, kanë qenë të përfshirë në Listën e Votuesve në Zgjedhjet Lokale 2013, por të cilët janë larguar midis dy palë zgjedhjesh, ku ky numër prej 27 304 emrave është hequr nga Lista e Votuesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2014.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me qëllim të informimit të votuesve të rinj, votuesve që kanë ndërruar adresë brenda komunës si dhe votuesi që kanë ndërruar adresa prej një komune në komunën tjetër, përmes kartolinave i ka njoftuar lidhur me caktimin e tyre në Qendra të Votimit. Numri total i votuesve që janë njoftuar përmes kartolinave, është: 42 951 votues.
Gjithashtu, Lista e Votuesve jashtë Kosovës 2014 ka përmbajtur të gjithë votuesit të regjistruar suksesshëm. Numri i përgjithshëm i votuesve jashtë Kosovës ka qenë 16 569. Në krahasim me zgjedhjet e kaluara (Zgjedhjet Lokale 2013) kemi pasur 2 916 votues më shumë, që janë regjistruar për të votuar përmes postës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 8 Qershor 2014.

Nr	Komunat	Numri i Votuesve	Numri i QV	Numri i VV
1	Deçan	40212	8	50
2	Gjakovë	107844	28	134
3	Gllogoc	50231	24	66
4	Gjilan	94425	33	125
5	Dragash	39172	31	57
6	Istog	45905	15	58

7	Kaçanik	32373	19	46
8	Klinë	44270	17	55
9	Fushë Kosovë	32085	10	40
10	Kamenicë	37428	26	55
11	Mitrovicë e Jugut	72764	28	97
12	Leposaviq	18268	18	31
13	Lipjan	55555	26	76
14	Novobërdë	9243	19	21
15	Obiliq	23224	14	33
16	Rahovec	53936	35	76
17	Pejë	103490	23	125
18	Podujevë	80526	43	109
19	Prishtinë	172289	56	218
20	Prizren	156970	67	211
21	Skenderaj	52641	32	72
22	Shtime	24511	11	33
23	Shtërpcë	13834	9	19
24	Suharekë	62230	32	85
25	Ferizaj	100675	32	128
26	Viti	46348	27	61
27	Vushtrri	68210	26	88
28	Zubin Potok	8021	12	16
29	Zveçan	9676	7	14
30	Malishevë	48430	35	71
31	Junik	5546	1	7
32	Mamushë	3642	1	4
33	Hani i Elezit	8554	4	11
34	Graçanicë	19623	10	27
35	Ranillug	5649	4	8
36	Partesh	4426	3	7
37	Klokot	3396	5	7
38	Mitrovicë e Veriut	26832	7	33
		1782454	798	2374

Tabela 18: Numri i votuesve, i QV-ve dhe i VV-ve ne te gjitha Komunat

NUMRI TOTAL I VOTUESVE (BRENDA DHE JASHTË VENDIT) **1, 799.023**	
Numri i votuesve brenda vendit **1,782 454**	Numri i Votuesve jashtë vendit **16 569**

6.1.5 Votimi jashtë Kosovës

Periudha e Regjistrimit për Votuesit jashtë Kosovës është zhvilluar në mes datave 13 maj 2014 dhe 19 maj 2014.

Para se të fillojë Periudha e Regjistrimit për Votuesit Jashtë Vendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u ka dërguar personalisht pakot me fletëvotime dhe me informacione përcjellëse, 13 653 votuesve, që në Zgjedhjet Lokale 2013 kishin arritur të dëshmonin kriteret e zotësisë juridike për të qenë votues.

Gjatë tërë Periudhës së Regjistrimit për Votim Jashtë Vendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pranuar 29 745 aplikacione për regjistrim. Aplikacionet për Regjistrim janë pranuar përmes Fahut Postar të KQZ-së, përmes Fax-it dhe përmes llogarive elektronike (E-mail) dhe përmes Ekipeve Transportuese.

Aplikacionet e Pranuara përmes:	Nr i Aplikacioneve të pranuara
Fahut Postar të KQZ-së	25
Përmes FAX-it	500
Përmes Emali-it	3411
Përmes Ekipeve Transportuese	25,263
Totali	29,199

Tabela 19: Aplikacionet e pranuara për Regjistrim.

Nga **29 745** Aplikacioneve të pranuara:

- **16 569** Aplikacione janë të aprovuara, dhe
- **13 176** Aplikacione janë refuzuar.

NR.	Shtetet	Numri i Aplikacioneve	APROVUAR	REFUZUAR

1	SERBI	25433	12901	12532
2	ZVICËR	1307	1169	138
3	GJERMANI	1268	1122	146
4	MALI I ZI	623	364	259
5	AUSTRIA	234	221	13
6	SHBA	136	115	21
7	SUEDI	111	99	12
8	Tjera	633	578	55
	Total	**29745**	**16569**	**13176**

Tabela 20. Numri total i Aplikacioneve të pranuara, të aprovuara, dhe të refuzuara te ndare sipas shteteve

Gjithashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për Periudhën e Regjistrimit për Votimin jashtë Vendit ka publikuar 190 pika shpërndarëse në 25 shtete të botës. Në pikat shpërndarëse kanë qenë të përfshira Ambasadat dhe Konsullatat e Republikës së Kosovës.

Pas përfundimit të Periudhës së Regjistrimit të Votuesve Jashtë Kosovës, si fazë e dytë e Operacionit të Votimit përmes Postës, është zhvilluar Periudha e Votimit dhe Vlerësimit të Pakove me Fletëvotime. Kjo Periudhë është ndërmarrë ndërmjet datave 27 maj 2014 deri me 6 qershor 2014. Gjatë kësaj periudhe, KQZ-ja ka pranuar 15 951 pako të fletëvotimeve.
Pas afatit të përcaktuar për pranimin e pakove me fletëvotime, për votuesit të cilët kishin arritur t'i dëshmonin kriteret e zotësisë juridike për të qenë votues jashtë Kosovës, vlerësimi i Pakove me fletëvotime ka filluar me datën 8 qershor 2014.
Nga 15 951 pako me fletëvotime të proceduara dhe vlerësuara:

a) Të Aprovuar kanë qenë **10 648**, dhe
a) Të Refuzuara kanë qenë **5 303.**

Shtetet	Votuesit e Aprovuar
Shqipëri	1
Australi	5
Austri	143
Belgjikë	42
Bosnja dhe Hercegovina	4
Kanada	5
Kroaci	11
Danimarkë	24
Finlandë	8
Francë	21

Gjermani	649
Greqi	1
Holandë	8
Islandë	2
Irlandë	1
Itali	16
Luksemburg	2
Maqedoni	3
Mali i Zi	247
Norvegji	14
Rumani	1
Skoci	4
Serbi	8551
Slloveni	32
Suedi	69
Zvicër	684
Turqi	7
Ugandë	1
Angli	43
SHBA	49
TOTAL	**10648**

Tabela 21: Pakot e fletëvotimeve të aprovuara që janë dërguar nga votuesit ku kanë vendbanimin/vendqëndrimin.

Për rastet e refuzuara të pakove me fletëvotime, më poshtë janë të listuara arsyet dhe numrin e rasteve të refuzimit:

- **414 Votues** që kanë dërguar pako me fletëvotime, por që nuk kanë aplikuar gjatë Periudhës së Regjistrimit,
- **137 Votues** që kanë aplikuar gjatë Periudhës së Regjistrimit, por që nuk janë aprovuar, gjegjësisht nuk kanë dëshmuar kriteret e zotësisë juridike për tu përfshirë në Listën e Votuesve jashtë Kosovës,
- **1 431 Aplikues** të suksesshëm që kanë tentuar të votojnë më shumë se një herë,
- **98 Votues** që kanë dërguar pako me fletëvotime e që nuk janë identifikuar se kujt i takon pakoja me fletëvotim,
- **3 223 Votues** që në Periudhën e Regjistrimit kanë aplikuar suksesshëm për tu përfshirë në Listën e Votuesve jashtë Kosovës, por që në Periudhën e Votimit nuk kanë dërguar kopje

të dokumentit të vlefshëm të identifikimit (ashtu siç e përcakton Rregulla Zgjedhore Nr. 03/ 2013 Votimi jashtë Kosovës, neni 4.2).

Gjithashtu, procesi i vlerësimit të fletëvotimeve për votuesit jashtë vendit, në vazhdimësi është vëzhguar nga vëzhguesit ndërkombëtar, si vëzhguesit e Bashkimin Evropian, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe subjektet e certifikuara politike
Pas përfundimit të procesit të verifikimit të pakove me fletëvotime për votuesit jashtë Kosovës, të gjitha pakot me fletëvotime janë klasifikuar në kutitë e votimit të identifikuara në bazë të komunave të Republikës së Kosovës, ku pastaj të gjitha pakot me fletëvotime janë dërguar në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve për numërim.

6.1.6 Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta

Lidhur me organizimin e Votimit për personat me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta, në bazë të vendimit të KQZ-së dhe Planit Operacional të Zgjedhjeve, Periudha e Regjistrimit të Votuesve me Nevoja të Veçanta – Votuesit e Ngujuar në Shtëpi, është ndërmarrë në mes të datave 20 maj 2014 dhe 29 maj 2014. Gjatë kësaj periudhe, 1 347 Votues kanë parashtruar kërkesat për regjistrim për votim përmes ekipeve lëvizëse.
Sa i përket numrit te votuesve me nevoja dhe rrethana të veçanta, gjegjësisht numri i votuesve për tri kategoritë është :

- Votuesit e ngujuar në shtëpi, 1347
- Votuesit në institucione, dhe 1465
- Votuesit në Rrethana të Veçanta 8

Numri i përgjithshëm i Votuesve me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka qenë: 2 820 Votues.
Ndërsa, sa i përket identifikimit të këtyre votuesve, Divizioni i Shërbimit të Votuesve, ka bërë identifikimin e vendvotimit për votuesit e të tria kategorive, me qëllim që një ditë para ditës së zgjedhjeve, emrat e tyre të vulosen në Listat Përfundimtare të Votuesve me vulën përkatëse të VPNV-së.
Të gjitha këto tabela me të dhënat e votuesve u janë dërguar Zyrtarëve të Lartë të Komisioneve Zgjedhore (ZLKZ)-ve me qëllim të përgatitjeve paraprake për ofrimin e mundësisë së votimit në ditën e zgjedhjeve.

Në kuadër të realizimit të së drejtës ligjore dhe qytetare për të votuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka realizuar projektin *"Krijimi i mundësive që votuesit e verbër dhe me të pamur të dobësuar të votojnë personalisht"*.

Projekti i tillë ka mundësuar sigurimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e të drejtës së votës për personat e verbër dhe personat me të pamur të dobësuar dhe krijimi i mundësive për votim të drejtpërdrejt nëpërmjet shabllonëve të Braj-it , si dhe informimi i votuesve të verbër për procesin zgjedhor të 8 Qershorit 2014.
Të gjitha materialet e nevojshme për këtë lloj të votimin janë shpërndarë në të gjitha qendrat e votimit në ditën e zgjedhjeve.

6.1.7 Informimi Publik

Për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës se Kosovës 2014, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka realizuar fushatën për informimin e votuesve për të gjitha aspektet dhe fazat e procesit zgjedhor.

Në funksion të kësaj, KQZ-ja ka hartuar dhe aprovuar Strategjinë e Informimit të Votuesve, qëllimi kryesor i së cilës është:

- *Informimi i votuesve për të gjitha fazat e procesit zgjedhor;*
- *Motivimin e qytetarëve me të drejtë vote për pjesëmarrje në zgjedhje si dhe për rolin, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre gjatë procesit zgjedhor.*

Në kuadër të zbatimit të informimit të votuesve lidhur me aspektet e ndryshme të procesit zgjedhor, janë zhvilluar dhjetëra aktivitete informuese nëpërmjet mediave, por edhe të takimit të drejtpërdrejt me votuesit.
Duke e ditur se procesi zgjedhor përfshin kategori të ndryshme votuesish, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe:

- *Informimit të qytetarëve me të drejtë vote që jetojnë jashtë Republikës së Kosovës, dhe*
- *Për periudhën se kur qytetarët me të drejtë vote, por me nevoja të veçanta, mund të regjistrohen si të tillë.*

Informimi për periudhën para ditës së zgjedhjeve, ka qenë faza e fundit e informimit, ku votuesit janë informuar se si të votojnë, si dhe janë inkurajuar për pjesëmarrje në zgjedhje.
Për të arritur një informim të suksesshëm, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka realizuar informim në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët në përdorim. Po ashtu, të gjitha produktet janë realizuar edhe në gjuhën e shenjave.

6.1.8 Trajnimi i KKZ-ve dhe KVV-ve

I gjithë trajnimi për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2014, është realizuar në përputhje me planin operacional të zgjedhjeve. Pas përpilimit dhe përgatitjes së doracakut të

trajnimit, është realizuar programi i trajnimit, i cili është zhvilluar në pesë cikle, duke përfshirë:

- Trajnimi i trajnerëve për procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotime.
- Trajnimi i trajnerëve të komunave përkatëse lidhur me procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotime.
- Trajnimi i ekipeve mobile për procedurat e votimit të personave me nevoja të veçanta (VPNV-ve).
- Trajnimi i komisioneve komunale zgjedhore (KKZ-ve) për procedurat e pranim-dorëzimit të materialeve.
- Trajnimi i këshillave të vendvotimeve (KVV-ve).

Objektiva të trajnimit kanë qenë ngritja e njohurive të stafit të angazhuar në proces zgjedhor në të gjitha nivelet.
Puna e cila e ka përshkuar trajnimin në bazë tëe Planit Operacional është ndarë në dy faza:

Trajnimi i anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve

Programi është zhvilluar duke u bazuar në këto module: përbërja, organizimi, struktura dhe funksionimi i KQZ-së dhe SKQZ-së. Në këtë program kanë prezantuar zyrtarët e departamenteve dhe divizioneve që kanë të bëjnë me fushëveprimet e tyre, duke përfshirë Zyrën për Certifikimin e Subjekteve Politike, Informimin Publik, Koordinimin në terren, Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, Zyrën Ligjore dhe Shërbimin Votues.

Trajnimi i Trajnerëve të SKQZ-së

Janë përpunuar modulet e procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim duke bërë krahasime si në metodologjinë e trajnimit, po ashtu në gjetjen e modaliteteve më të mira të mundshme për bartjen e mesazheve të qarta prej trajnerëve e deri tek anëtarët e KVV-ve. Procedurat e VPNV-ve, Procedurat e Pranim-dorëzimit te materialit zgjedhore nga KVV-te deri te Zyrat e Komisioneve Komunale te zgjedhjeve.

Trajnimi i trajnerëve të terrenit

Trajnimi ka pasur agjendë katër ditore dhe janë zhvilluar gjithsej tetë (8) module. Me qëllim të implementimit të rekomandimeve nga zgjedhjet e kaluar, në këtë trajnim jemi fokusuar në shtjellim më të detajuar të moduleve, si në vijim: shënjimi i fletëvotimit, procesi i numërimit, plotësimi i FPR-së/FRK-së si dhe paketimi.

Trajnimi i ekipeve Mobile të VPNV-ve

Në kuadër të organizimit të trajnimit për ekipet mobile dhe me qëllim të ofrimit të mundësisë së votimit për votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta, trajnimi është zhvilluar në gjashtë **(6)** module.

Trajnimi i Trajnerëve të QNR-së

Trajnimi është zhvilluar vetëm në tri (3) module në të cilat është fokusuar çështja e paketimit të materialeve në kutitë e votimit dhe në plotësimin e raportit te KKZ-ve për materiale, të cilat procedohen në QNR.

Trajnimi i Anëtarëve të KKZ-ve

Trajnimi për procedurat e Pranim-dorëzimit të materialit zgjedhor nga KVV-të deri në zyrat e KKZ-ve, është zhvilluar në **tetë (8)** module. Vëmendje e veçantë i është kushtuar modulit të rregullsisë dhe kompletimit te materialeve të ndjeshme në Kutitë e Votimit.

Trajnimi i anëtarëve të KVV-ve

Trajnimi është në bazë të planit operacional nëpër të gjitha komunat. Janë shtjelluar tetë (8) module të procedurave të votimit dhe numërimit. Kujdes i është kushtuar modulit të shënjimit të Fletëvotimit, numërimit dhe paketimit.

Trajnimi i Kryesuesve të KVV-ve

Krahas trajnimit të KVV-ve, me kryesuesit e KVV-ve është mbajtur trajnimi njëditor, kushtuar detyrave dhe përgjegjësive të kryesuesve të KVV-ve që kanë të bëjnë me plotësimin e FPR-së, FRK-së si dhe tek paketimi.

Mbikëqyrje dhe monitorim i procesit të trajnimit të KVV-ve nëpër komuna

Sipas një plani dinamik të miratuar nga KE, trajnimi është monitoruar ne shumicën e komunave nga ekipe të Sekretariatit të KQZ-së.

Monitorimi i Procesit zgjedhor në Ditën e zgjedhjeve

Bazuar ne planin operacional për ditën e zgjedhjeve, ekipe të monitorimit nga Sekretariati i KQZ-së, kane monitoruar procesin zgjedhor ne komunat e Kosovës, përkatësisht në qendrat e votimit.

Përmes linjës ndihmese nga dhoma operative, qytetarët dhe stafi i angazhuar janë ndihmuar dhe këshilluar për çështje qe kane te bëjnë me procedura të votimit në ditën e zgjedhjeve.

Koordinimi në Terren

Sipas planit operacional, KQZ-ja me datë 8 maj 2014 u ka bërë ftesë subjekteve politike për nominimet e Anëtarëve të KKZ-ve. Pas pranimit të nominimeve, është bërë verifikimi i nominimeve me qëllim të plotësimit të kritereve ligjore. KQZ- ja, me datën 14 maj 2014 ka bërë emërimin e anëtarëve të KKZ-ve për tërë komunat e Republikës se Kosovës. Mirëpo kemi pasur edhe afat shtesë për emërimin e KKZ-ve.
Bazuar ne planin operacional, me datën 20 maj 2014 është bërë ftesë për subjektet politike për nominimin e anëtarëve të KVV-ve. Me datën 27 maj 2014, KQZ-ja ka bërë emërimin e anëtareve të KVV-ve. Pas emërimit të KVV-ve dhe përzgjedhjes së stafit teknik të QV-ve, është bërë shtypja e distinktivëve të anëtareve të KVV-ve dhe stafit teknik të QV-ve.
Është hartuar dhe miratuar nga KQZ-ja Plani Operacional i Sigurisë, i përgatitur dhe zbatuar në partneritet të plotë më Policinë e Kosovës (PK).
Në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor mbështetur në Planin Operacional të Sigurisë, SKQZ-ja ka mbajtur Programin Orientues me Policinë e Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2014. Ky program është mbajtur me datë 23 maj 2014, ku pjesëmarrës kanë qenë drejtorët e rajoneve të Policisë dhe zyrtarët policor përgjegjës për implementimin e Planit Operacional të Sigurisë.
Pas finalizimit të lokacioneve finale për Qendrat e Votimit dhe depot e KKZ-ve, bazuar në planin operacional, me datë 25 maj 2014 është bërë publikimi i Qendrave të Votimit për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2014.
KQZ-ja ka miratuar kodin e mirësjelljes për anëtarët e KKZ-së dhe KVV-ve, ku secili anëtar ka nënshkruar Kodin e mirësjelljes. Është dërguar në terren Udhëzimi për Menaxher dhe stafin teknik të QV-ve.
Koordinimi në Terren në bashkëpunim me Divizionin e Logjistikes ka bërë të gjitha përgatitjet për pranimin e materialit Sensitiv në Depon Qendrore të KQZ- së dhe shpërndarjen e tij nëpër KKZ.

Qoftë nga KQZ-ja, Subjektet Politike, OJQ-te Policia, Prokuroria, Organizatat ndërkombëtare të akredituara nga KQZ-ja për vëzhgimin e zgjedhjeve etj. Raporti ne mes këtyre akterëve ka qene ne nivelin e duhur, mirëpo me prokurorinë kemi pasur disa mosmarrëveshje lidhur me komunikimin ndërmjet dy institucioneve ne nivel qendror dhe lokal. Në dy prej komunave, prokurorë të angazhuar në ditën e zgjedhjeve nuk kane pasur njohuri te mjaftueshme për vendimet e marra me herët nga KQZ-ja lidhur me procesin zgjedhor, me ç'rast veprimet e ndërmarra nga prokurorët kanë krijuar keqkuptime në opinion dhe pengesa në punën e KKZ-ve dhe stafit të QV-ve, mirëpo në një konferencë të jashtëzakonshme, Kryetarja e KQZ-së ka bërë

sqarimet rreth vendimeve te KQZ-së. Në dhomën operative që është në funksion të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve janë paraqitur gjithsej njëzet e një (21) raste në nëntëmbëdhjetë Qendra të Votimit nëpër komuna të ndryshme, si: ankesa, kërkesa për sqarime, njoftime/reagime nga subjektet, KKZ-të KVV-të, anëtarët e KQZ-së, policia, me ç'rast zyrtarët përgjegjës nga SKQZ-ja në dhomën operative kanë marrë veprimet e menjëhershme ligjore në zgjidhjen dhe parandalimin e problemeve në vijueshmërinë e procesit zgjedhor. Është trajtuar secili rast i paraqitur nga organet përkatëse, në të cilin kanë qenë kompetentë.

Përgatitjet për ditën e zgjedhjeve

Me datë 7 qershor 2014, në ora 06:00, është bërë shpërndarja e materialit të ndjeshëm zgjedhor. Materiali është shpërndarë nga Depo Qendrore e KQZ-së nëpër Depo të KKZ-ve, vendet ku ka qëndruar materiali i ndjeshëm janë siguruar nga Policia e Kosovës. Janë shpërndarë kartelat e identifikimit për anëtarët e KVV-ve dhe stafit teknik të QV-ve.

Dita e Zgjedhjeve

Dhoma Operative e KQZ-se është hapur në orën 04:00 të mëngjesit të datës 08. 06. 2014. Sipas Planit Operativ të Sigurisë, kjo kohe ka qenë kur ka filluar shpërndarja e materialit sensitiv nga Depo të KKZ-ve për në Qendra të Votimit. Materiali ne fjalë ka filluar të shpërndahet nëpër QV me datë 08.06.2014 në orën 04:30 të mëngjesit.
Shpërndarja e materialit sensitiv nëpër tërë QV-të e komunave përkatëse ka përfunduar në ora 06:15. Të gjitha Qendrat e Votimit janë hapur në ora 07:00 pa asnjë problem. Dhoma operative ka pranuar informacione nga të gjitha QV-të ne tërë Kosovën dhe sipas nevojave zyrtare dhe përgjegjësive iu kemi përgjigjur me të gjithë akterët. Qoftë nga KQZ-ja, Policia , Prokuroria etj., Raporti në mes të këtyre akterëve ka qene në nivelin e duhur, mirëpo me prokurorinë kemi pasur disa mosmarrëveshje lidhur me komunikimin ndërmjet dy institucioneve në nivel qendror dhe lokal.

Çështjet Ligjore

Departamenti për Çështje Ligjore që nga dita e shpalljes së Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të datës 8 qershor 2014, është angazhuar në dhënien e ndihmës profesionale juridike, në interpretimin ligjor të KQZ-së dhe Sekretariatit të KQZ-së. Departamenti gjatë kësaj periudhe të raportimit kryesisht është angazhuar në:

- Përpilimin e vendimeve, memorandumeve të mirëkuptimit, kontratave, dhe shkresave zyrtare,

- Përgjigjen në ankesa dhe kërkesa,
- Përfaqësimin e KQZ-së në procedurat gjyqësore dhe konteste tjera,
- Përgatitjet e agjendave, mbledhjeve të KQZ-së, Këshillit të procedurave, Këshillit të Operacioneve Zgjedhore dhe Menaxhmentit të SKQZ-së,
- Shqyrtimin e kërkesave të kryesuesve të kuvendeve komunale, për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale.
- Përgatitjen e raportit të planit të veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, në të cilën është pasqyruar puna dhe aktivitetet e KQZ-së, në kuadër të përmbushjes së objektivave të PV për MSA-në i cili është dërguar në mënyrë periodike (çdo tre muaj) në Ministrinë e Integrimeve Evropiane (MIE).
- Pjesëmarrjen në tryezat e organizuara nga Instituti i Kosovës për Drejtësi "Drejtësia në zgjedhjet e 8 qershorit", së bashku me Prokurorin e Shtetit, Policinë e Kosovës, dhe PZAP-in, në shtatë (7) Regjionet e Kosovës.
- Në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Shtetit, kemi siguruar listën emrave të këshillave të vendvotimeve që janë dënuar me Aktgjykimet e plotfuqishme dhe emrat e anëtarëve të KVV-ve, të cilët janë nën hetime, të cilët nuk janë emëruar në KVV nga KQZ-ja, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2014.

Të angazhuarit në procesin zgjedhor

Në vitin 2014 janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Mitrovicën e Veriut dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvend te Kosovës. Në të dy këto procese zgjedhore është paraqitur nevoja për rekrutimin e stafit te përkohshëm. Për stafin e angazhuar në këto zgjedhje nuk janë zhvilluar procedura të rekrutimit, por stafi është angazhuar ai që ka qenë edhe ne zgjedhjet lokale 2013.
Më poshtë është pasqyruar tabela në mënyrë të klasifikuar, për stafin e angazhuar në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare 2014, për Kuvendin e Kosovës.

Përshkrimi	Stafi i angazhuar
KKZ-të e angazhuar	259
Stafi jo permanent	286
Trajnerët nëpër komuna	301
Anëtarë të KVV-ve	23,088
QNR (stafi ne numërim, ne projektin K-Vote dhe Stafi për	1,785

aplikacione OVPP)	
Total	25,719

Tabela 22:Stafi i angazhuar në Zgjedhjet e parakohshme Parlamentare 2014

Për të gjithë stafin e angazhuar në proces zgjedhor janë përgatitur kontratat dhe lënda komplet është dërguar për pagesë.

Logjistika dhe transporti

Fillimisht nga Divizioni i Logjistikës dhe Transportit u identifikuan nevojat për staf dhe materiale te nevojshme duke marre parasysh se ishte vit zgjedhor, siç ishin të planifikuara edhe në buxhet. Përshkrimi i aktiviteteve për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës:

- Specifikimi i materialeve zgjedhore, si: Material administrativ për pakot e vendvotimeve, Format zgjedhore për vendvotimet e rregullta, me kusht, qendrat e vendvotimeve me nevoja te veçanta – VPNV, dhe të pranim-dorëzimit - INTAKE.
- Specifikimi i UV –sprejave, specifikimi i UV – llampave, specifikimi i baterive për UV llampë, specifikimi i Vulave për fletëvotim, jastëk dhe ngjyre për vulë, specifikimi i kabinave të votimit, specifikimi i lidhëseve të sigurisë.
- Specifikacionet teknike për transport
- Furnizimi me materiale administrative u bë për tërë stafin e KQZ-së, SKQZ-së me të gjitha materialet e mundshme për mbarëvajtjen e këtij procesi zgjedhor.
- Identifikimi i hapësirave të nevojshme për punë, zyrë, automjete
- Furnizimi me materiale administrative për Listën Votuese .
- Furnizimi me te gjitha materialet për Qendrën e Numrimit dhe te Rezultateve .
- Është bere paketimi i tërë materialeve zgjedhore për secilin vendvotim dhe secilën komune. secilën qendër votimi me materialet e nevojshme të cilat do të shfrytëzoheshin në ditën e zgjedhjeve.
- Është bërë ndarja dhe paketimi, si dhe përgatitja të gjitha materialeve zgjedhore në depon qendrore për secilën komunë.
- Është bërë shpërndarja e të gjitha materialeve zgjedhore për secilën komunë dhe transportimi i këtyre materialeve të ndara për secilën komunë, secilin vendvotim, të ndarë me gjuhë zyrtare, në baze të planit operacional.

Baza e të dhënave

Administrimi i bazave të të dhënave për procesin zgjedhor përfshinë një numër aktivitetesh operacionale dhe të ndjeshme, të cilat janë të nevojshme dhe të ndërlidhura në procese dhe

operacione zgjedhore. Krijimi i Listës votuese përfshinë krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave nga ekstrakti i regjistrit civil i plotësuar edhe me atribute tjera, siç janë të dhënat për qendrat e votimit dhe vendvotimet. Gjatë gjithë procesit të punës janë aplikuar standarde dhe parime qe kanë garantuar siguri dhe qëndrueshmëri në sisteme të të dhënave.

Aktivitetit primar për njësinë e bazës së shënimeve ka qenë përpilimi, azhurnimi dhe finalizimi i Listës së Votuese. Përmbushja e kësaj detyre ka qenë sfidë e madhe, për shkak të kohës së shkurtër. Por vlen të theksohet se problemet të cilat janë evidente në Listën Votuese, gjegjësisht në mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të Listës Votuese, janë nga Regjistri Qendror Civil, në të cilin kemi probleme të shumta sidomos me adresa dhe të dhëna të personave të cilat nuk janë azhurnuar (update adresat dhe P – codet). Aktivitetet kryesore në kuadër të krijimit të Listës Votuese kanë qenë :

- Përpunimi i te dhënave nga ekstrakti i Regjistrit Civil,
- Analizimi i Listës Preliminare të Votuesve të 2014-ës,
- Caktimi automatik i votuesve,
- Krijimi dhe dërgimi i listave për caktim manual të ZKLZ-të,
- Bashkimi i votuesve
- Përpunimi i të dhënave për dërgimin e letrave tek votuesit të caktuar në Qendra të reja të votimit,
- Krijimi i skedarëve PDF të Listës së Votuesve,
- Caktimi/ndarja në vendvotimeve

Para fillimit të Operacionit të votimit përmes postës janë modifikuar dhe përshtatur aplikacionet që kanë të bëjnë me ketë operacion. Është modifikuar dhe përshtatur për këto zgjedhje aplikacioni me modulet :

- Moduli për regjistrim,
- Moduli për verifikimin e zotësisë juridike,
- Moduli për verifikimin e pakove te fletëvotimeve.

Nga kopjet rezervë (back up) të bazës se te dhënave nga Zgjedhjet Lokale 2013 janë nxjerr të dhënat në lidhje me votuesit e aprovuar suksesshëm për dërgimin e letrave njoftuese. Gjatë fazës së regjistrimit ka pasur një numër të madhe të aplikacioneve për regjistrim, të gjithë këto aplikacione janë proceduar për regjistrim, është bërë verifikimi i zotësisë juridike dhe vlerësimi i pakove të fletëvotimeve, gjithmonë përmes aplikacionit.

Me kërkesën e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike është bërë verifikimi i kandidatëve që kanë aplikuar për certifikim për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2014.
Është bërë verifikimi i të dhënave për vëzhguesit vendore të cilët kanë aplikuar për akreditim për

vëzhgimin e zgjedhjeve, në disa raste për shkak të mosplotësimit te Listave me të dhënat themelore (emri, mbiemri, numri i ID-së dhe data e lindjes) është dashur të bëhet verifikimi manual, respektivisht eliminimi i personave të dyfishtë, krahasimi me listat e KVV-ve.

Dizajnimi dhe shtypja e Fletëvotimeve dhe Broshurave

Dizajni i fletëvotimeve dhe broshurave ka filluar menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve. Është dizajnuar Fletëvotimi i formatit A3 për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, si dhe broshura që ka përfshirë mbi 1,000 kandidatë të subjekteve politike.
Në të njëjtën kohë është bërë hartimi i specifikave teknike për broshura dhe fletëvotime, të cilat kanë përmbajtur specifikimet teknike në detaje për shtypin, transportin, paketimin dhe elementet e sigurisë që duhet t'i përmbaj secili fletëvotim.
Pas hartimit specifikave, ato janë shqyrtuar në Menaxhmentin e SKQZ-së, Këshillin e Operacioneve Zgjedhore, ku me sugjerimet e KOZ-it, janë miratuar në KQZ dhe janë proceduar për prokurim.
Procesi i shtypit dhe paketimit të 1,686,350 fletëvotimeve dhe 26,114 broshurave, ka zgjatur 11 ditë.

Dizajnimi i formularëve të zgjedhjeve dhe materialeve tjera zgjedhore

Janë dizajnuar të gjitha llojet e formularëve të zgjedhjeve në gjuhet zyrtare. Këta formularë kemi arritur që t'i dizajnojmë bazuar në planin operacional, dhe janë shqyrtuar nga departamentet dhe divizionet brenda SKQZ-së. Po ashtu janë dizajnuar doracakët për trajnim, ftesat, posterët, ID-të, vizitkartat, që janë shfaq si kërkesa nga departamentet e SKQZ-së.
Është bërë zhvillimi i programit për tërheqje të shortit të subjekteve politike.

Përditësimi i ueb faqes

Ueb faqja e KQZ-se ka qenë mjaft e vizituar, nga qytetarët dhe akterët e tjerë të përfshirë në zgjedhje .
Numri i vizitave nga data 8 maj 2014, datë kur është shpallur dita e zgjedhjeve dhe deri me datën 8 qershor 2014, ka qenë gjithsej 652,722

- Ne gjuhen Shqipe: 619,040
- Ne gjuhen Serbe: 26,749
- Në gjuhën Angleze: 6,933



Numri i vizitave në makinën kërkuese për informata lidhur me qendrën e votimit

Nga data 14 maj 2014 kur është publikuar makina kërkuese për herë të parë e deri ne ditën e zgjedhjeve më 8 qershor 2014, numri i vizitave në makinën kërkuese për të dhënat e votuesve në ueb faqen e KQZ-së është **276,050** :

- Ne gjuhën shqipe: 243,651
- Ne gjuhën serbe: 32,062
- Ne gjuhën angleze: 337



Vizita gjatë periudhës së shërbimit votues në makinën kërkuese

Gjatë periudhës së shërbimit votues nga datat 14 deri me 24 Maj, numri i vizitave në makinën kërkuese ka qenë gjithsej 59,451:

- Në gjuhën Shqipe: 37,129 vizita
- Në gjuhën Serbe: 22,284 vizita
- Në gjuhën Angleze: 38 vizita

6.2 Numërimi dhe tabulimi i rezultateve

Numërimi në vendvotim

Pas përfundimit të procesit të votimit në vendvotim, në të cilin proces në orën 19:00 mbyllen të gjitha vendvotimet, fillon menjëherë procesi i numërimit të fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta, ndërsa Votat me Kusht (VK), Votat e Personave me Nevoja të Veçanta (VPNV) dhe Votat përmes Postës (VPP) numërohen në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Procesi i numërimit të votave nga vendvotimet e rregullta, zyrtarisht fillon në ora 19:00, pasi të kenë përfunduar të gjitha proceset dhe procedurat e votimit gjatë ditës. Ne ketë proces të numërimit përpos anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit (KVV), të kryesuar nga Kryesuesi i Vendvotimit, marrin pjesë edhe vëzhguesit e akredituar nga subjektet Politike dhe organizatat joqeveritare. Së pari numërohen votat për Subjekte Politike e pastaj numërohen votat e Kandidatëve. KQZ-ja pas kompletimit të numërimit të votave për Subjekte politike i publikon përmes projektit K-Vote Rezultatet Preliminare nga secila Qendër e votimit dhe Vendvotim.

Publikimi i rezultateve preliminare – K VOTE

KQZ-ja në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2014 ka implementuar projektin e publikimit të Rezultateve Preliminare, duke i publikuar të gjitha rezultatet e votave të numëruara për secilin vendvotim në kohë reale. Rezultatet Preliminare - K-VOTE, mundësojnë grumbullimin e të dhënave, tabelimin dhe transmetimin LIVE të Rezultateve Preliminare të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2014 në ueb-faqen e KQZ-së, në kohën sa më të shpejtë pas përfundimit të procesit të Votimit dhe të gjitha Procedurave të Numërimit të fletëvotimeve nga secili vendvotim, në të gjitha komunat në Republikën e Kosovës qe do te mbahen zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2014.
Përmes këtij projekti KQZ publikon të dhënat mbi pjesëmarrjen e votuesve në votime në 3 termine kohore (11:00, 15:00 dhe 19:00) gjatë ditës së zgjedhjeve si dhe Rezultatet Preliminare pas përfundimit të procesit të numërimit të fletëvotimeve për Subjekte Politike nga secili vendvotim.

RAPORTIMI NË DITËN E ZGJEDHJEVE
Në ditën e zgjedhjeve me 8 qershor, stafi i K-VOTE ka dërguar të dhënat nga 754 QV,
Pjesëmarrja në Zgjedhje, ora 11:00 9.87%

Pjesëmarrja në Zgjedhje, ora 15:00 26.50%
Pjesëmarrja në Zgjedhje, ora 19:00 43.25%

Ndërsa pas përfundimit të procedurave të numërimit për vendvotim, stafi i K-Vote ka dërguar të dhënat mbi votat nga FPR për Subjekte Politike. Të dhënat e para mbi votat e subjekteve janë transmetuar ne ueb-faqe te KQZ-së në orën 20:20.
Të dhënat mbi Rezultatet Preliminare janë transmetuar Online në ueb-faqen e KQZ-së nga ku secili qytetar brenda dhe jashtë vendit ka mundur t'i përcjell përmes internetit. Nga tabela shihet numri i vizitorëve të ueb-faqes së KQZ-së në orën 15:00 mbi daljen në votime.

Për 2 ditë me 8 dhe 9 qershor, në ueb-faqen e KQZ-së janë bërë 2.939.151 klikime nga 121.511 përdorues, çka do të thotë se qytetaret janë informuar direkt mbi rezultatet Preliminare nga secila qendër e votimit, përkatësisht vendvotim.

Tabulimi i rezultateve

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve - është lokacioni ku pranohet i gjithë materiali zgjedhor nga secili vendvotim, kontrollohen, procedohen të dhënat nga secili Formular i Përputhjes se të dhënave dhe Rezultateve, Formular i Rezultateve të Kandidatëve dhe Formulari i Rezultateve të Dengut, numërohen fletëvotimet me Kusht, fletëvotimet e Votimit të Personave me Nevoja të Veçanta, fletëvotimet për votim jashtë Kosovës si dhe çdo fletëvotim i rregullt me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, dhe pas kompletimit të të gjitha proceseve të lartcekura, tabelohen dhe përpilohen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve bëhet futja e të dhënave nga Formularët e Rezultateve për Subjekte Politike dhe për Kandidatë nga vendvotimet e rregullta, auditimi i tyre, skanimi i Listave Përfundimtare të Votuesve (LPV) si dhe verifikimi dhe numërimi i Fletëvotimeve me Kusht (FK), Votave të Personave me Nevoja të Veçanta (VPNV) dhe Votat Përmes Postës (VPP) në softuerin e QNR-së, i cili bën procesimin e të gjitha këtyre të dhënave për tabelimin dhe përpilimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga QNR.

Në Softuerin e QNR-së bëhet regjistrimi i të gjithë artikujve që pranohen nga komunat, respektivisht nga te gjitha vendvotimet. Artikujt që do të regjistrohen dhe procesohen në databaze janë Formularët e përputhjes se të dhënave dhe Rezultateve (FPR), Formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) Libri i Votimit, Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV), Thesi i ZFK-ve, VPNV, Fletëvotimet me Postë, Kutia e Votimit. Softueri do të shfrytëzohet për futjen e të dhënave të FPR, FRK, FRD, auditimi i tyre, skanimi i LPV si dhe verifikimi i ZFK, VPNV dhe VPP me

ç'rast pas procesimit te të gjitha këtyre të dhënave do të bëhet procesimi i të gjitha këtyre të dhënave për tabelimin dhe përpilimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga QNR.
Për qëllime të saktësisë së Rezultateve Përfundimtare të gjitha të dhënat nga Formularët e Rezultateve procesohen sipas sistemit "Blind Data Entry" që do të thotë se të njëjtat të dhëna nga i njëjti Formular i Rezultateve procesohen 2 (dy) herë nga 2 (dy) nëpunës të ndryshëm dhe verifikohen nga mbikëqyrësi për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të procesuara kundrejt atyre në formën fizike nga Formulari i Rezultateve.

Stafi është i obliguar ti shënojë të dhënat ashtu siç janë në Formular të Rezultateve pa marrë parasysh se a kane Formularët e Rezultateve parregullsi me të dhëna apo jo. Vetëm Formularët e Rezultateve të cilët janë brenda nivelit të tolerancës procesohen si të rregullta, ndërsa ata Formular të Rezultateve të cilët tejkalojnë ketë nivel të Tolerancës, auditohen dhe verifikohen të dhënat.

Procesi në futjen e të dhënave nuk ka mundur të kompletohet pasi që një numër i FRK nuk kanë mundur të kalojnë auditimin për arsye se kanë pasur mospërputhje në mes të FPR dhe FRK. Mospërputhjet janë në shumicën e rasteve kur kandidatët kanë më shumë vota se sa Subjekti, që sipas sistemit (shih raportin e QNR-së datës 17.06.2014) nuk kanë mundur të procedohen si të rregullta. Sipas procedurave të QNR-së kandidatët brenda një Subjekti duhet të kenë vota baras me subjektin ose më pak, por në asnjë mënyrë të mos kenë vota më shumë se Subjekti. Nga raporti shihet se kandidatët sipas kategorive kanë vota më shumë se Subjektet.
Janë edhe disa raste jo në numër sikur rasti i mësipërm, mirëpo arsyeja pse kanë dështuar të kalojnë auditimin është sepse tek Subjektet nuk kanë të shënuar asnjë votë ndërsa kandidatët kanë vota. Sipas procedurave edhe ne këtë rast kandidatët duhet të kenë vota baras sa Subjekti ose më pak, e ne ato raste kur Subjekti nuk ka vota, as kandidatët nuk duhet të kenë vota.
Për eliminimin e këtyre parregullsive KQZ ka marrë vendim për Rinumërimin e 439 Vendvotimeve të cilat pas Rinumërimit në QNR janë procesuar dhe i janë bashkangjitur Rezultateve Përfundimtare nga QNR.

Rezultatet përfundimtare

Pas përfundimit te të gjitha procedurave të përpilimit dhe tabulimit të Rezultateve, KQZ-ja me date 26 qershor 2014 ka shpallur Rezultatet përfundimtare nga QNR. Pas shpalljes se rezultateve ka pasur ankesa dhe disa rinumërime me vendim te PZAP, mirëpo edhe pas rinumërimit nuk ka pasur ndonjë efekt tek rezultatet e subjekteve dhe rezultatet e kandidateve të cilët kanë fituar ulëse në Kuvend dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave të ankesave ne PZAP dhe Gjykatën Supreme, KQZ i ka shpallur Certifikuar me 2 korrik 2014.

Për më shumë detaje rreth rezultateve përfundimtare shih:
Rezultatet për Kuvendin e Kosovës 2014: http://www.kqz-ks.org/sq/rezultatet-2014

6.3 Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut

Pasi që kandidati i zgjedhuri për kryetar komune në Mitrovicë të Veriut refuzoi që të bëjë betimin, Presidentja e vendit znj. Atifete Jahjaga, me date 20 janar 2014, ka marrë vendim për mbajtjen e zgjedhjeve te jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e veriut, të cilat u mbajtën më 23 shkurt, 2014. KQZ-ja, me qellim te përmbushjes se mandatit ligjor, ka hartuar dhe miratuar Planin Operacional për këto zgjedhje.

Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/l-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe me Rregullës Zgjedhore nr.08/2013 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, KQZ-ja ka pranuar aplikacionet e katër Subjekteve Politike për t'u Certifikuar për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetare Komune në Mitrovicën e Veriut, të cilat janë mbajtur me 23.02.2014. Pas shqyrtimit të këtyre aplikacioneve, Zyra i ka rekomanduar Komisionit Qendror Zgjedhor Certifikimin e katër (4) kandidatëve të Subjekteve Politike.

Akreditimi i vëzhguesve

Në pajtim me nenin 54 te Ligjit nr. 03/l-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 3 të Rregullës Zgjedhore Nr. 07/2013 Vëzhguesit e Zgjedhjeve, Zyra pas shqyrtimit të aplikacioneve për akreditim ka rekomanduar KQZ-së për akreditimin e njëqind e nëntëdhjetë e pesë (195) vëzhguesve për monitorimin e Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetare Komune në Mitrovicën e Veriut.

Nr i Subjekteve	Lloji i Subjektit/Organizatës	Nr i vëzhguesve të akredituar
2	Parti Politike	69
2	Nisma Qytetare	48
7	Ambasada	40
1	Organizata Ndërkombëtare	13
3	OJQ-vendore	25
	Gjithsej	195

Tabela 23: Vëzhguesit e Akredituar për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetare Komune në Mitrovicën e Veriut 2014

Lista votuese

Lista Përfundimtare e Votuesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Mitrovicës së Veriut 2014 ka përmbajtur 28 429 emra të votuesve. Numri i Qendrave të Votimit (QV) ka qenë 7, ndërsa numri i vendvotimeve ka qenë 33.
Votuesit e rinj që kanë pasur mundësinë për të votuar për herë të parë në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Mitrovicës së Veriut të 24 shkurtit 2014, kanë qenë 927 votues të rinj.

- 342 votues të rinj që pas Zgjedhjeve Lokale 2013 kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Mitrovicës së veriut,

- 585 votues që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve 2013 për Komunën e Mitrovicës së Veriut, e që mund të konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil midis dy palë zgjedhjesh.

Lidhur me Periudhën e Shërbimit të Votuesve për ndërrimin e qendrave të votimit, të gjithë votuesit kanë pasur mundësi që t'i vizitojnë zyrat e Komisioneve Komunale Zgjedhore (nga data 25 Janar 2014 deri me datën 7 Shkurt 2014) për t'u informuar se në cilën qendër të votimit janë caktuar ose të kërkojnë ri-caktim të qendrës së votimit më të përshtatshme për ta. Gjatë kësaj periudhe njëmbëdhjetë votues kanë parashtruar kërkesë për ndërrim të Qendrave të Votimit në zyrën e Komisionit Komunal Zgjedhor.

Ndërsa, Periudha e Sfidimit dhe Kundërshtimit të Listës së Votuesve që është zhvilluar në mes datave 3 shkurt 2014 deri me datën 7 shkurt 2014. Gjatë kësaj periudhe, asnjë votues ose palë e interesuar nuk ka parashtruar kërkesa për sfidimin dhe kundërshtimin e Listës së Votuesve.

Votimi përmes Postës

Programi i votimit me Postë është ndërmarrë në mes datës 24 janar 2014 dhe 2 shkurt 2014. Divizioni i Shërbimit të votuesve ka dërguar shtatëmbëdhjetë aplikacione për regjistrim votuesve që në zgjedhjet e kaluara kishin arritur të dëshmonin kriteret e zotësisë juridike për të votuar. Deri në përfundim të periudhës së regjistrimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka pranuar asnjë kërkesë për regjistrim për votim jashtë Kosovës.

Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta

Lidhur me organizimin e Votimit për personat me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta, në bazë të vendimit të KQZ-së dhe Planit Operacional të Zgjedhjeve, Periudha e Regjistrimit të Votuesve me Nevoja të Veçanta – Votuesit e Ngujuar në Shtëpi, është ndërmarr në mes datave 4 Shkurt 2014 deri më 12 shkurt 2014. Gjatë kësaj periudhe, 116 votues kanë parashtruar kërkesat për regjistrim për votim përmes ekipeve lëvizëse. Ndërsa, sa i përket identifikimit dhe regjistrimit të votuesve në institucione dhe që kanë qenë votues të Mitrovicës së veriut në Listën përfundimtare të Votuesve, 4 votues janë identifikuar dhe iu ka mundësuar votimi ne ditën ë zgjedhjeve përmes ekipeve mobile.

Numërimi dhe Rezultatet

Pas përfundimit te të gjitha procedurave të përpilimit dhe tabulimit të Rezultateve, KQZ-ja me date 26 shkurt 2014 ka shpallur Rezultatet përfundimtare nga QNR.
Pas përfundimit të afateve për ankesa ne PZAP dhe Gjykatën Supreme, KQZ-ja i ka certifikuar rezultatet me 3 mars 2014 .

7 SFIDAT DHE REKOMANDIMET

7.1 Sfidat dhe mangësitë

Gjatë realizimit të aktiviteteve për vitin raportues, KQZ-ja krahas të arriturave dhe përparësive, ka hasur në sfida ose pengesa. Disa nga sfidat dhe mangësitë, efekti i të cilave mund të ndikojë negativisht në realizimin e aktiviteteve është:

1. Hapësira për punë në ndërtesën ku është vendosur KQZ-ja është e pamjaftueshme për punë normale.

2. Trajtimi i stafit të Sekretariatit të KQZ-së si shërbyes civilë dhe me paga jashtëzakonisht të ulëta, po ndikojnë negativisht në ruajtjen e stafit dhe qëndrueshmërisë profesionale.

3. Mungesat dhe zëvendësimet e anëtarëve të këshillave të vendvotimeve.

4. Mungesa e rregullativës ligjore për funksionimin e KKZ-ve.

5. Kërkesat e shumta gjykatave për rinumërim, pjesëmarrje në seancat gjyqësore dhe dërgimin e materialeve zgjedhore lidhur me procedurat penale kundër personave të akuzuar për shkeljet e bëra gjatë procesit zgjedhor.

6. Mos integrimi i sistemit të adresave në Regjistrin Qendror Civil ndikon në krijimin e Listës Votuese jo të sakte.

7. Gjatë procesit të krijimit të listës së votuesve për këto zgjedhje, duke përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve, kemi pasur ankesa të qytetarëve me të drejtë vote, të cilët nuk e kanë qenë fare në Listën e Votuesve. Për të gjithë këto raste, ne kemi parë që votuesit e tillë kanë qenë votues në zgjedhjet paraprake (Zgjedhjet Lokale 2013), e për këto zgjedhje janë larguar nga Regjistri Qendror Civil, respektivisht edhe nga Lista e Votuesve. Pra,këto raste kanë rrjedhur gjatë skanimit të librave amë të të vdekurve, për të cilat raste është njoftuar Agjencioni për Regjistrim Civil dhe bashkërisht kemi konstatuar se bëhet fjalë për largimin e emrave të personave të cilët janë larguar si pasojë e gabimeve, pra janë larguar si të vdekur.

8. Mbingarkesa në Qendrat e Votimit në qytetet e mëdha, ku për çdo palë zgjedhje numri i votuesve shkon duke u rritur për shkak të mungesës së adresave në Regjistrin Civil.

9. Vështirësitë në ofrimin e shërbimeve për votuesit jashtë Kosovës, në Zgjedhjet e parakohshme dhe jashtëzakonshme, për shkak të procedurave të komplikuara ligjore, mungesës se stafit dhe afateve të shkurtra.

10. Vonesat ne publikimin e rezultateve janë shkaktuar nga mënyrat e votimit që ofrohen, si: Votimi me kusht, VPNV dhe me postë ka ndikuar ne vonimin e publikimit te rezultateve Përfundimtare.

11. Gabimet gjatë plotësimit të formularëve nga anëtaret e KVV-ve.

12. Numri i madh i stafit për t'u trajnuar dhe koha e shkurtër.

7.2 Rekomandimet

Me qëllim të tejkalimit të sfidave dhe të vështirësive të lartpërmendura dhe konform vizionit për të ndërtuar një institucion profesional dhe të qëndrueshëm të administrimit të zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, rekomandon:

1. Caktimi i një objekti të përhershëm dhe të përshtatshëm si seli e KQZ-së.

2. Trajtim meritor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe personelin e tij që është i specializuar në fushën e organizimit të zgjedhjeve, sikurse institucionet e tjera të cilat kanë bazë të njëjtë kushtetuese.

3. Definimi i qartë i të drejtës së votës për votuesit që jetojnë jashtë vendit dhe të përcaktohet vetëm për qytetarët e Republikës së Kosovës të regjistruar në Regjistrin Civil, dhe të pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton që, personave që nuk janë të regjistruar në Regjistrin Qendror Civil, të mos u lejohet pjesëmarrja në votime, dhe vlerësimi i këtyre kritereve të mos jetë në kompetencë të KQZ-së.

4. Rishikimi i mënyrës së votimit jashtë vendit, largimi i votimit jashtë vendit për Zgjedhjet Lokale. Ndërsa, lehtësimi i këtij procesi për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke iu dhënë hapësirë më madhe për pjesëmarrje të gjithë qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit.

5. Të gjenden mekanizmat për t'i identifikuar qytetarët e Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit, dhe kanë të drejtë vote si dhe shënimin e tyre në Regjistër Civil, dhe në Listën e Votuesve.

6. Heqjen e votimit me kusht dhe angazhimi i institucioneve relevante shtetërore për të përmirësuar të dhënat mbi qytetarët me të drejt vote në Regjistër Civil, si bazë për krijimin e një liste të votuesve të saktë dhe të qëndrueshme.

7. Definimi i qartë i dokumenteve të identifikimit të votuesve gjatë procesit të votimit, duke caktuar vetëm dokumentet shtetërore të Republikës së Kosovës, kuptohet, si dokumente të vlefshme për identifikim.

8 RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr.	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati i zbatimit	Efekti
1	Të sigurohet se janë bërë analiza të mjaftueshme lidhur me nevojat për punë shtesë, dhe nëse kjo është e nevojshme, para ekzekutimit të pagesave të sigurohet dëshmi e mjaftueshme se është realizuar në tërësi puna jashtë orarit bazuar në vendimet e nxjerra.	Analizat për punë shtesë janë bërë nga të gjitha njësitë kërkuese, sipas specifikave të punëve dhe vëllimit të tyre. Në proces zgjedhor është e domosdoshme që stafi permanent të angazhohet me gjatë se orari i rregullt i punës e ngandonjëherë edhe 24 orë pandërprerë, kjo për shkak të kërkesave të mëdha për punëtorë dhe numër të kufizuar të stafit permanent. Dëshmi të punës jashtë orarit të rregullt të punës janë vendimi për zgjatjen e orarit të punës deri në ora 19:00 për tërë stafin permanent dhe puna gjatë vikendit, të shtunën nga ora 8-19 dhe të dielën nga ora 10-16. Po ashtu, dokument i cili mbështet punën jashtë orarit të punës është edhe plani i veprimit për organizimin e zgjedhjeve i miratuar nga KQZ-ja, që obligon stafin për organizim të zgjedhjeve pa llogaritur kohën dhe koston, për shkak të ndjeshmërisë së procesit zgjedhor. Edhe vendimi i Qeverisë së Kosovës, për ndarjen e fondeve në kategorinë për paga dhe mëditje, është marrë në bazë të llogaritjeve dhe kërkesës për mbulimin e punës shtesë të stafit, gjatë procesit zgjedhor. Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes ka përgatitur llogari te veçanta për punën shtesë të secilit anëtarë të stafit dhe anëtarëve të KQZ-së, e cila është bërë në bazë të ligjit të punës dhe udhëzimit për pagesën e punës jashtë orarit të punës.	30.08.2014	Përkundër tentativës për të siguruar një dokumentacion mbështetës në formë specifikimi për pagesat shtesë gjatë zgjedhjeve, nuk është arritur efekti i kërkuar me rekomandime të AGJ. Rekomandimi është adresuar por jo edhe plotësuar tërësisht.

2	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë me vlerë mbi 1,000€ duhet të realizohen nga kategoria e Investimeve Kapitale, të regjistrohen si pasuri në SIMFK, dhe të prezantohen në PVF.	Janë diskutuar në menaxhment, janë sqaruar rekomandimet e AGJ-së dhe është vendosur që edhe buxhetimi i blerjes së pasurive me vlerë mbi 1.000.00 euro dhe ekzekutimi I buxhetit për këtë kategori të bëhet nga kategoria e investimeve kapitale. Nga viti 2014 do të zbatohet në mënyrë strikte edhe ky rekomandim i AGJ-së, i cili kërkon një menaxhim më të mirë të pasurive dhe një raportim më të saktë dhe më të plotë sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar. Furnizimet me TI në vitin 2014, kontrata nr. 320 14 031 131 e datës 05.05.2014, janë realizuar nga kodi I investimeve kapitale si projekt i veçantë. Rekomandimi është zbatuar plotësisht.	30.11.2014	Të gjitha pasuritë me vlerë mbi 1000 euro janë regjistruar në SIMFK. Rekomandimi sipas vlerësimit të menaxhmentit është zbatuar, efekti është prezantimi i pasurive kapitale me pamje të drejt në PVF.
3	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësisë më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Menaxhmenti në baza të rregullta.	Është përgatitur plani i zbatimit të rekomandimeve të AGJ-së, është nxjerrë vendimi i KQZ-së, zbatimi i rekomandimeve në vazhdim sepse zbatimi është proces që kërkon kohë. Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të AGJ-së nga menaxhmenti është në funksion të rishikimit të zbatimit të rekomandimeve të AGJ-së. Rekomandimi është zbatuar plotësisht.	30.11.2014	Plani i zbatimit të rekomandimeve është përgatitur, është nxjerrë vendimi i KQZ-së, janë përcaktuar afatet e zbatimit të rekomandimeve. Efekti nga zbatimi i tyre jo i dëshirueshmi për arsye të vazhdimit të moszbatimit të disa rekomandimeve dhe zbatimit jo të plotë të disa prej tyre.
4	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë kontrolle shtesë në kuadër të sektorit të	-Është adresuar rekomandimi dhe zbatimi praktik dëshmohet me projektin e TI-së ku pagesa është bërë nga kodi i investimeve kapitale madje edhe me kod të	27.12.2014	Rekomandimi është adresuar, janë bërë përmirësime, ka përsëritje të mospërputhjes së kodeve

	pagesave, në mënyrë që shpenzimet të klasifikohen dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël të miratuar.	projektit. Edhe ne pagesat nga kodet tjera janë ndërmarrë veprimet që pagesat të bëhen nga kodet përkatëse. Dëshmi janë anulimet e zotimeve të caktuara për shkak të kodeve ekonomike jo adekuate, të bëra me kërkesë të zyrtarëve zotues apo certifikues.		ekonomik me përmbajtjen e shpenzimeve. Efekti prezantimi jo i duhur i shpenzimeve në PVF.
5	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurohet se komisionet e vlerësimit janë duke bërë vlerësimin e drejtë të ofertave, duke respektuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit.	-Është tepër subjektive vlerësimi i ofertave nga komisioni vlerësues, janë komisione jo të përhershme dhe që caktohen për çdo ofertë. Përpjekjet për të caktuar anëtarë komisionesh profesionalë janë në fokusin e menaxhmentit. Përmirësime të vazhdueshme janë të nevojshme. Rekomandimi është adresuar	30.11.2014	Rekomandimi i adresuar, jo i plotësuar tërësisht, përbërja e komisioneve është e përcaktuar edhe me kapacitetet momentale por edhe me numrin e stafit në dispozicion. Efektet janë në përzgjedhjen e kontratave më të favorshme të pamatshme. Ka nevojë për përmirësime.
6	Kryetarja e KQZ-së duhet të shqyrtojë mundësinë e zhvillimit të procedurave të prokurimit në mënyrë që të sigurojë shërbime efikase me çmime më të favorshme.	Përdorimi i procedurave të rregullta të prokurimit në shumicën e rasteve, pas auditimit të AGJ-së, është zbatuar dhe mund të ketë ndonjë shmangie në të ardhmen vetëm në raste emergjente të lejuara edhe me ligjin e prokurimit publik. Rekomandimi është adresuar	30.11.2014	Rekomandimi përkundër kërkesave për përdorim të procedurave të rregullta dhe ndonjë përmirësimi, duhet siguruar në të ardhmen zbatim më të madh të procedurave të hapura. Efekti pranimi i furnizimeve dhe shërbimeve më të pafavorshme dhe çmime më pak ekonomike.
7	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë një planifikim më të hershëm për fillimin e realizimit të procedurave të prokurimit, për të reduktuar sa më shumë procedurat e negocimit pa publikim të	Planifikimi I prokurimit dhe plani I zbatimit për vitin 2014 ka qenë të përgatitur. Mbajtja para kohe e zgjedhjeve parlamentare në qershor 2014 në vend të muajt dhjetor, ka imponuar rishikimin e procedurave të prokurimit. Organizimi I zgjedhjeve para kohe ka imponuar zhvillimin e procedurave të negociuara pa publikim njoftimi për kontratë. Të gjitha kontratat nga programi I Sekretariatit	30.11.2014	Rekomandimi i AGJ-së për reduktimin e procedurave të negociuara, në masën më të madhe është mbetur i njëjtë, ka pasur përmirësime por në pjesën dërmues të kontratave ka mbizotëruar procedura e

	njoftimit për kontratë. Në kushtet e një konkurrence të mirëfilltë, mund të arrihet cilësia më e lartë për çmime më të ulëta, dhe mundëson që fondet të shpenzohen në mënyrë më efektive.	janë me procedura të hapura. Rekomandimi është adresuar		negociuar. Efektet furnizime dhe shërbime më të shtrenjta dhe jocilësore të mundshme.
8	Kryetarja e KQZ-së duhet të forcojë kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.	Është ndërtuar një procedurë e procesimit të pagesave e cila përcakton hapat për kryerjen e pagesave OE, sipas ligjit për menaxhimin e financave publike dhe rregullat e thesarit. Rekomandimi është adresuar	30.11.2014	Rekomandimi është zbatuar në masë të madhe, është ndërtuar një procedurë e të pagesave. Efekti ndarja e përgjegjësive dhe përmirësimi i kontrollit të brendshëm.
9	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se në komisionin vlerësues të tenderëve, janë pjesëmarrës vetëm zyrtarët te cilët nuk krijojnë konflikt interesi me pozitat e ushtruara nga ana e tyre.	Është një konstatim i AGJ-së i saktë, që ka të bëjë më negocimin e kontratave për zgjedhjet e parakohshme 2014. Veprimet e tilla nuk do përseriten. Rekomandimi është adresuar	25.12.2014	Rekomandimi është adresuar dhe plotësuar dhe nuk ka raste përveç atyre të gjetura nga AGJ, ku zyrtari i prokurimit ka qenë në përbërje të komisionit vlerësues. Efekti zbatimi i ligjshmërisë dhe përmirësimi i kontrollit të brendshëm.
10	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se raporti për kontratat e nënshkruara publike është i plotë, duke përfshirë të gjitha procedurat	Është një konstatim i AGJ-së i saktë që ka të bëjë më negocimin e kontratave për zgjedhjet e parakohshme 2014,veprimet e tilla nuk do përsëriten pas rekomandimit dhe veprimet në vazhdim do të jenë konform Ligjit të prokurimit publik. Në veçanti është diskutuar në menaxhment dhe është vlerësuar se një veprim i njëjtë	30.11.2014	Rekomandimi është plotësuar, raporti i kontratave të nënshkruara sipas prokurimit është i plotë dhe nuk ka asnjë kontratë të pa proceduar. Efekti raportimi i plotë dhe prezantimi i vlerës së

	e realizuara për vitin përkatës.	nuk do të përsëritet. Rekomandimi është adresuar		kontratave të nënshkruara në mënyrë të saktë.
11	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se para fillimit të çdo procedure të rekrutimit, bëhet kërkesa inicuese nga departamenti përkatës, dhe që e njëjta aprovohet nga zyrtarët kompetentë.	Për të gjitha rekrutimet që kanë filluar në vitin 2014 janë plotësuar kërkesat inicuese nga njësitë kërkuese të rekrutimit. Rekomandimi është zbatuar plotësisht.	30.12.2014	Rekomandimi është zbatuar plotësisht, në të gjitha rastet e rekrutimeve të reja janë iniciuar kërkesat për rekrutim nga njësitë kërkuese. Efekti zbatimi i ligjshmërisë dhe arsyeshmerisë së kërkesës.
12	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se procedurat e rekrutimit fillojnë me kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se tre muaj.	Nuk është adresuar dhe nuk është ndërmarrë ndonjë veprim i plotësimit të pozitave me Ushtrues detyre.	30.12.2014	Nuk është zbatuar rekomandimi, pjesa dërmuese e pozitave të planifikuar të plotësohen në vitin 2014, sipas planit të punës nuk janë plotësuar. Efekti mos planifikimi i duhur për staf apo rrezikim i arritjes së objektivave për mos kompletim të kapaciteteve. Po ashtu edhe plotësimi i pozitave U.D nuk është adresuar dhe vazhdojnë të punojnë si të tillë.Efekti është jo ligjshmeria dhe efektet në arritjen e objektivave për shkak të mos definimit të statusit të tyre
13	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se me rastin e rekrutimit të personelit, procesi të jetë objektiv dhe transparent, duke synuar që të pranohet stafi sa më cilësor dhe më i dobishëm për	Në rastet e zhvilluara në vitin 2014, kërkesat e rekomandimit të AGJ-së janë zbatuar. Dëshmi mbështetëse, dosjet e rekrutimit për vitin 2014.	25.12.2014	Rekomandimi është vlerësuar, janë bërë përmirësime, megjithatë përmirësime të tjera në proces duhen bërë. Efektet e moszbatimit të këtij rekomandimi, rrezikimi i arritjes së objektivave të institucionit.

	pozitën e kërkuar.			
14	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë që janë duke u zbatuar të gjitha kërkesat ligjore gjatë procesit të rekrutimit dhe të gjithë kandidatët vlerësohen duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në konkurs.	Kërkesat e AGJ-së janë 30.11.2014 zbatuar në rastet e rekrutimit pas auditimit.	31.12.2014	Në shumicën e rekrutimeve për zhytarë komunal janë zbatuar kërkesat ligjore dhe janë vlerësuar sipas kritereve të kërkuara, Por në disa raste të shpalljeve ka pasë anulime të konkurseve të shpallura për shkak të shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme dhe për arsye tjera.
15	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se çdo pasuri e shfrytëzuar nga entiteti, furnizohet dhe regjistrohet sipas barkodeve të përkatëse.	Është iniciuar kërkesa dhe kanë filluar angazhimet në bashkëpunim me MAP-in për funksionalizimin e programit të E-pasurisë. Duhet të plotësohet nga brenda apo të rekrutohet në zyrtarë për pranim të furnizimeve sepse të qenit vetëm të një zyrtari I cili është edhe ud. i menaxherit të logjistikës edhe pranues malli (deposit), është konflikt interesi dhe nuk mund të ushtrohet kontroll i mirëfilltë. Rekomandimi është adresuar	31.12.2014	Rekomandimi është adresuar, është në funksionalizim edhe sistemi E-Pasuri dhe të gjitha kërkesat e rekomandimit do të zbatohen. Probleme ka në regjistrimin, kodifikimin dhe lëvizjen e pasurisë dhe të tjera. Menaxhimi jo i duhur i pasurisë dhe mundësitë e humbjes së tyre.
16	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se ka ndërmarrë masat e nevojshme për të funksionalizuar KA-në, me qëllim që të shfrytëzohet kontributi i tyre në përmirësimin e kontrollit të brendshëm të financave publike.	Nuk është funksionalizuar komiteti i auditimit. Rekomandimi nuk është adresuar	31.11.2014	Rekomandimi nuk është zbatuar. Me planin e punës 2015 është planifikuar formimi i komitetit të auditimit. Efekti - mungesa e mbikëqyrjes dhe kontrollit në auditim të brënshëm, neglizhimi në zbatimin e rekomandimeve të AGJ dhe AB.

17	Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se janë vendosur bazat për një bashkëpunim më të mirë me subjektet politike, me qëllim të inkurajimit në adresimin e rekomandimeve, të dhëna në raportet e auditorit.	Bazat e bashkëpunimit me subjekte politike ekzistojnë, është një përpjekje e ZRPÇ-së që të rris nivelin e bashkëpunimit.	30.09.2014	Rekomandimi është adresuar në fushën e financave të partive politike dhe raportimit të tyre, një adresim tjetër duhet bërë në inkurajimin e rekomandimeve të dhëna nga AGJ-ja për subjektet politike.

9 SHTOJCAT

1. *Shtojca 1 - Plani i Punës se KQZ-së për vitin 2014*
2. *Shtojca 2 – Pasqyrë përmbledhëse për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës*
3. *Shtojca 3 – Raporti Financiar Vjetor 2014*
4. *Shtojca 4 - Organograni*

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Plani i Punës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014

HYRJE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucion i pavarur i themeluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas nenit 139, paragrafi 1 "është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre". Në përmbushjen e këtyre detyrave dhe obligimeve kushtetuese, KQZ-ja mbështetet nga dy trupa administrative siç janë: Sekretariati i KQZ-së dhe Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike.

Me qëllim të implementimit të përgjegjësive dhe detyrave të veta, harton dhe miraton ketë Plan të Punës për vitin 2014, i cili paraqet prioritetet e institucionit për vitin 2014 dhe jep përmbledhje të aktiviteteve të planifikuara për realizimin e synimeve operative të përcaktuara për vitin 2014. Po ashtu, i njëjti përcakton edhe afatet kohore, institucionin përgjegjës për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara, si dhe koston financiare.

Objektivi Nr. 1 - Transparenca e punës së KQZ-së

Numri Rendor	Aktiviteti	Afatet Kohore	Përshkrimi	Përgjegjës	Mbikëqyrja e Aktiviteteve
Rezultati 1.1 KQZ pasqyron punën për vitin 2013, analizon procesin zgjedhore dhe harton politika funksionale					
1.1.1	Raport nga SKQZ-ja, për implementimin e planit të punës për vitin 2013	31 janar	Raport detal lidhur me implementimin e aktiviteteve nga plani i punës 2013	KQZ / SKQZ	KOZ/KQZ
1.1.2	Hartimi i Planit të Veprimit 2014	20 janar	Plani i veprimit përmban të gjitha aktivitet në funksion të realizimit që dalin nga plani i punës për vitin 2014.	KQZ / SKQZ	
1.1.3	Publikimi i raportit statistikore për trendët zgjedhorë 2000 - 2013	31 janar	Raporti përmban të dhëna për pjesëmarrjen e votuesve, në bazë të grupmoshave, gjinive. Krahasimin e numrit te votave me kusht, pavlefshme.	KQZ	KOZ/KQZ
1.1.4	Analiza e Procesit të Zgjedhjeve Lokale 2013 me zyrtarët komunalë	20 janar	Analiza e procesit zgjedhor me zyrtarët komunalë, përvojat dhe mësimet e zëna në secilën komunë përgjatë zgjedhjeve lokale 2013.	KQZ/SKQZ	KQZ
1.1.5	Analiza e Procesit të Zgjedhjeve Lokale 2013 (mësimet e zëna)	30 janar	Analiza e procesit zgjedhor, të arriturat, sfidat dhe përvojat që mund të shfrytëzohen.	KQZ/SKQZ	KOZ KBP
1.1.6	Raportimi i Pasqyrave financiare te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve për vitin 2013	31 janar	Bazuar ne Ligjin nr. 03 /L 048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 44.1 dhe neni 44.2, KQZ-ja duhet të raportojë tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të vitit fiskal.	KQZ	KBP

1.1.7	Raporti i shpenzimeve zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2013	Shkurt	Bazuar ne Ligjin 03/L-073, neni 113.6 brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve prej ditës së shpalljes të rezultateve zyrtare të zgjedhjeve, KQZ-ja do të publikojë një raport të plotë për shpenzimet zgjedhore dhe mënyrën e shpenzimit.	KQZ/SKQZ	KP KOZ KBP KP
1.1.8	Raporti për Kuvendin e Republikës së Kosovës	31 mars	Bazuar ne Ligji Nr. 03/L-073, neni 63.10 KQZ-ja i përgatit Kuvendit të Kosovës një raport vjetor dhe atë në muajin prill. Raporti përmban informata lidhur me aktivitetet e KQZ-së dhe rekomandimet që KQZ-ja i sheh si të përshtatshme që të trajtohen në Kuvend.	KQZ	Komisioni AD-HOC (duhet të themelohet)
1.1.9	Raporti dhe vlerësimi i zbatimit të planit të punës te vitit 2014	20 prill, 20 korrik, 20 tetor	SKQZ-ja harton raport për zbatimin e planit të punës dhe e prezanton në KQZ në tri periudha.	KQZ/SKQZ	KOZ
1.1.10	Raportimi i progresit nga KQZ-ja për Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim asocimit	Mars, qershor, shtator, dhjetor	Raportimi periodik në bazë të udhëzimeve të MIE-së për ndërmarrjen e aktiviteteve / progresit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.	KQZ/SKQZ	Komisioni AD-HOC
1.1.11	Raporti vjetor për Kuvendin e Kosovës për shpërndarjen dhe shpenzimin e mjeteve nga fondi për financimin e subjekteve politike	Maj - qershor	Bazuar ne Ligjin 03/L174, neni 15, KQZ-ja duhet t'i publikojë të gjitha raportet vjetore financiare së bashku me deklaratën e auditimit të subjekteve politike në faqen zyrtare të saj.	KQZ	KBP
1.1.12	Hartimi i planit strategjik të KQZ-së për vitin 2015 - 2018	Janar – prill	Dokumenti i cili identifikon, vlerëson dhe rekomandon një grup të politikave dhe veprimeve për arritjen e një prioriteti ose synimi të caktuar, për një periudhë jo më të shkurtër se tre vjet.	KQZ	KP
1.1.13	Kompletimi i komitetit te auditimit	31 janar	Ligji për auditimin e brendshëm 03/ L-128. Komiteti i auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për menaxhmentin e lartë të subjektit te sektorit publik dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.	KQZ	KQZ

